



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 193 Akti

Nr. 224 Vendimi
Tiranë, më 20.12.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatini, në datë 18 dhjetor 2019, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Astrit Kalaja, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër – me përfaqësues ligjor prezent në seancën dëgjimore.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit dhe përfaqësuesin e tij ligjor, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, e cili në seancën dëgjimore publike të datës 18.12.2019, kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Z. Astrit Kalaja, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër ka dorëzuar në ILDKPKI, DSIK dhe në KLD dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Pika 4, e neni 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: “*Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio*”. Në këto kushte, ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Astrit Kalaja.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 17 shtator 2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Brunilda Bekteshi dhe Lulzim Hamitaj.
- iv. Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 3, pasi administroi dhe studioi tri raportet e institucioneve, të parashikuara nga nenet 31 – 44, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 24 shtator 2018, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
- v. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e subjektit, z. Astrit Kalaja, në datën 27 nëntor 2019, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet, dhe në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuar nga ligji nr. 84/2016.
- vi. Në datën 28.11.2019, Komisioni, njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: rezultatet e hetimit kryesisht - duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën - për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë prej 11 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.

- vii. Pasi u njoh me dosjen, subjekti i rivlerësimit paraqiti brenda afatit të caktuar shpjegimet e veta të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.
- viii. Në datën 13.12.2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 3 - vendosi të ftojë - përmes postës elektronike - subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore në datën 18.11.2019, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatini, si dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesit ligjor të zgjedhur nga subjekti.
- ii. Në vijim, pasi dëgjuan relacionin, z. Astrit Kalaja dhe përfaqësuesi i tij kanë parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, të cilat i kanë paraqitur edhe me shkrim, së bashku me dokumentacion provues.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 18.11.2019 u mbyll, për të rifilluar më 20.11.2019, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e përpiluar nga Inspektorati i Lartë i KLD-së dhe dokumentet shkresore të përcjella nga Shkolla e Magjistraturës; (dh) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; e) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore; dhe (ë) faktet e njohura botërisht.

A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 5.2.2018, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” ka deklaruar pasuritë, si më poshtë:

- i. Apartament me sip. 109.5 m², me vlerë 4.675.650 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, ndodhur në lagjen “****”, Rr. “****”, Shkodër, me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***. Burimi i krijimit: të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme dhe nga kredia bankare.
- ii. Tokë arë, me sip. 379 m², ku rezultojnë 60 m² sipërfaqe ndërtimi, me vendndodhje në fshatin ***, Velipojë. Vlera e kësaj pasure është deklaruar 1.800.000 lekë (*deklaratat periodike vjetore dhe/ose* në deklaratën “Vetting”), në bashkëpronësi me bashkëshorten. Burimi i krijimit: nga kredi bankare.
- iii. Apartament me sip. 62 m², me vlerë tregu 3.500.000 lekë, me pjesë takuese 5/12 në zotërim të bashkëshortes, ndodhur në lagjen “M. A.”, Shkodër. Kjo banesë rezulton të ketë një shtesë me sip. prej 10 m², ende në proces legalizimi. Burimi i krijimit: kontratë shitblerje, sipas ligjit për privatizimin e banesave shtetërore (vlera e kohës 12.000 lekë) dhe trashëgimi ligjore, heqje dorë nga një prej trashëgimtarëve.
- iv. Automjet tip “Mercedes Benz”, viti i prodhimit 1999, në vlerën 250.000 lekë, në pronësi të subjektit, me targa ***, blerë sipas deklaratës zëvendësuese të aktit noterial me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 16.6.2014. Burimi i krijimit: kursime familjare.
- v. Gjendje *cash* në vlerën 350.000 lekë në bashkëpronësi me bashkëshorten.
- vi. Gjendje në llogarinë bankare të subjektit dhe të bashkëshortes në vlerën 558.837,23 lekë.
- vii. Gjendje në llogarinë bankare të vajzës së subjektit në vlerën 3.115,55 euro.

viii. Burimi i krijimit¹: kursime nga paga e subjektit dhe bashkëshortes.

A/1 VLERËSIMI I PASURISË

1) Apartament me sip. 109.5 m², me vlerë 4.675.650 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, ndodhur në lagjen “***”, Rr. “***”, Shkodër, me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***.

1.1 Subjekti e ka fituar këtë pasuri përmes kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 29.7.2009, lidhur me të cilën, më herët ishte nënshkruar kontrata e sipërmarrjes me nr. ***, datë 28.2.2008. Vlera e pasurisë sipas kontratës së shitblerjes ka qenë 4.675.650 lekë, ndërsa burimi i krijimit për të është deklaruar nga kredia bankare dhe nga shitja e pasurisë së paluajtshme me nr. *** e ndodhur në Shkodër.

1.2 Ka rezultuar se subjekti me kontratën me nr. ***, datë 14.2.2007, ka përfituar një kredi në vlerën 3.000.000 lekë, nga Banka Kombëtare Tregtare për blerje banese. Në momentin e lëvrimit, kredia në falë është garantuar përmes kontratës së hipotekimit nr. ***, datë 14.2.2007, mbi apartamentin me sipërfaqe 63 m² dhe me numër pasurie ***, ndodhur në z.k. ***, Shkodër.

1.3 Në datën 20.2.2007 nga BKT-ja është disbursuar kredia në vlerën 2.970.000 lekë dhe në datën 27.2.2007 nga subjekti është tërhequr *cash* shuma prej 2.946.000 lekësh.

1.4 Më pas, me kontratën me nr. ***, datë 24.12.2007, subjekti ka siguruar kredinë e mësipërme me depozitë bankare në vlerën 3.300.000 lekë pranë BKT-së, duke liruuar në këtë mënyrë pasurinë e paluajtshme nga hipoteka e çuar më herët për të njëjtin qëllim.

1.5 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 subjekti ka deklaruar pagimin e shumës prej 3.000.000 lekësh, si këst i parë për blerjen e një apartamenti në vlerën 38.400 euro, si dhe ka deklaruar si burim krijimi kredinë e marrë pranë BKT-së

Në lidhje me shumën e përdorur për sigurimin e kredisë

1.6 Me kontratën me nr. ***, datë 24.12.2007, subjekti ka siguruar kredinë e mësipërme me depozitë bankare në vlerën 3.300.000 lekë pranë Bankës Kombëtare Tregtare. Për këtë qëllim, në të njëjtën datë z. Rr. P., ka derdhur në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, pranë BKT-së shumën prej 3.300.000 lekësh, me përshkrimin “*derdhje në llogari për shlyerje kredie*”.

1.7 Lidhur me këtë marrëdhënie, nëpërmjet pyetësorit nr. 2 të datës 18.4.2019, subjekti është pyetur mbi kthimin mbrapsht të kësaj shume dhe mbi mundësitë financiare të z. Rr. P. për të dhënë këtë shumë. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhurat e z. Rr. P. janë kthyer me mandatarkëtimin në datën 23 shkurt 2012, në vlerën 2.000.000 lekë, dhe pjesa tjetër gjatë viteve në mënyrë të herëpashërëshme, por nuk mund të përcaktoj kohën.*”

1.8 Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare evidentohet që nga llogaria e garancisë bankare në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, në datën 8.6.2010, është tërhequr shuma

2.000.000 lekë², ndërsa më tej në datën 23.2.2012 nga e njëjta llogari është tërhequr shuma prej 1.300.000 lekësh.

1.9 Nga shqyrtimi i deklaratave periodike vjetore për vitet 2007, 2010 dhe 2012 nuk rezulton që nga subjekti të jetë deklaruar as marrja dhe as mbartja si detyrim për shumën prej 3.300.000 lekësh ndaj z. Rr. P. dhe njëkohësisht nuk rezulton të jenë deklaruar shlyerjet e këtyre shumave në vitet 2008 – 2013, ndaj tij;

1.10 Ndërsa, në datën 26.3.2010 subjekti ka depozituar *cash* në llogarinë bankare në BKT shumën 2.000.000 lekë, të cilën në po të njëjtën datë, e ka përdorur për pagesën e *principalit* të kredisë pranë kësaj banke dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti ka deklaruar një pakësim të gjendjes *cash* në shumën 2.000.000 lekë, shumë e cila është përdorur për shlyerjen e kredisë.

1.11 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka vënë gjithashtu në dispozicion një deklaratë noteriale me nr. ***, të datës 23.10.2014³, ku ndër të tjera z. Rr. P. deklaron: “[...]...duke filluar nga shtatori i vitit 2008 e deri në kohën që ka përfunduar shlyerja e kredisë në muajin shkurt 2013, nga z. Astrit Kalaja, kohë pas kohe, kam marrë shuma parash që varionin nga 50.000 - 150.000 lekë të reja...” [...] “Me mbylljen e kredisë, lekët që kishin mbetur në llogarinë e garancisë, në shumën rreth 1.300.000 lekë, ia kam kthyer z. Astrit Kalaja, meqenëse gjatë viteve që kjo shumë ka qenë e bllokuar, unë këto lekë ia kisha marrë”.

1.12 Për sa i përket mundësisë financiare të z. Rr. P. nga subjektit janë vënë në dispozicion ekstraktet e lëvizjeve bankare në të cilat evidentohet se ka lëvizje të vlerave monetare të konsiderueshme në llogari të z. Rr. P. dhe të bashkëshortes – edhe në sajë të fitimeve nga një aktivitet tregtar – restorant, që ka prej shumë vitesh pranë ***. Gjithashtu, është depozituar edhe një kontratë shitblerjeje nga ku rezulton se z. Rr. P. ka shitur një pasuri (dyqan), në vlerën 28.500.000 lekë, në vitin 1996.

1.13 Nga analizimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, ka rezultuar se në datën 26.12.2007, subjekti nëpërmjet kontratës nr. ***, ka shitur pasurinë apartament banimi me nr. pasurie ***, në vlerën prej 3.500.000 lekësh⁴. Kjo pasuri ishte blerë nga subjekti në bazë të kontratës nr. 9/2, datë 4.1.2003, me një çmim prej 1.900.000 lekësh⁵. Burimi financiar për këtë blerje është deklaruar se ka qenë shitja e shtëpisë së vjetër (e përfituar në bazë të ligjit për privatizimin e pronës shtetërore në emër të z. Xh. K. (shitur në vlerën 1.500.000 lekë).

² Tërheqje e kryer në bazë të kërkesës për tërheqje të firmosur nga klienti Astrit Kalaja.

³ Sipas deklaratës noteriale, datë 23.10.2014, të bërë nga z. Rr. Z. P., të përsëritur me të njëjtën përmbajtje edhe në datën 6.1.2017 (dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI).

⁴ Sipas përshkrimit në kontratë vlera e kontratës do të likuideohej përmes llogarisë bankare në “Tirana Bank”, por në fakt shuma prej 3.300.000 lekësh, ka kaluar në datën 4.3.2008, në “Raiffeisen Bank”, kurse pjesa prej 200.000 lekësh sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin nr. 2 është paguar *cash* në vitin 2007.

⁵ Çmimi sipas kontratës së shitblerjes.

Lidhur me deklaratimet e gjendjes *cash* nga subjekti i rivlerësimit

1.14 Subjekti ka deklaruar kursime *cash* në banesë, prej vitit 2004 e në vijim, mbi të cilat është ftuar nga Komisioni të japë sqarime nëpërmjet pyetësorit nr. 2, datë 18.4.2019. Në bazë të një përlllogaritje të gjendjeve *cash* ndër vite, sipas deklaratave të subjektit (mbi shtesat dhe pakësimet *cash*), dalin rezultate të ndryshme nga përshkrimi i bërë nga subjekti në pyetësor.

1.15 Gjithashtu, nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare, si dhe i deklaratimeve të subjektit në pyetësorin nr. 2, evidentohet që në vitin 2008 subjekti ka tërhequr në datat 21.4.2008 dhe 6.5.2008, përkatësisht shumat prej 1.000.000 lekësh dhe 2.500.000 lekësh (të cilat buronin nga shitja e apartamentit në vitin 2007). Në formularin e deklaratimit të pasurisë për vitin 2008, subjekti ka deklaruar një shtesë të gjendjes *cash* prej 400.000 lekësh, si kursime përgjatë këtij viti, nga puna e tij dhe e bashkëshortes, pa u shprehur mbi shumën prej 3.500.000 lekë të tërhequra në llogarinë bankare përgjatë po këtij viti (2008).

1.16 Në shpjegimet e dhëna nga subjekti në pyetësorin nr. 2, këto shuma të tërhequra në vitin 2008, deklarohen të përdorura pjesërisht si burim financiar për pagesën e kështit të dytë për blerjen e apartamentit në vitin 2009 (në shumën 1.700.000 lekë), si dhe për shlyerjen e parakohshme të kredisë, në vitin 2010 (depozituar në bankë 2.000.000 lekë).

1.17 Duke kryer mbledhjen në mënyrë kumulative që prej deklaratimit për herë të parë të kursimeve *cash*, në vitin 2004 dhe në vijim - pa konsideruar shumën 3.500.000 lekë të përfituar nga shitja e apartamentit të depozituara në bankë dhe më pas të tërhequra në vitin 2008 - konstatohet se subjekti nuk do të kishte mundësi të përballonte (vetëm me gjendjen *cash* të deklaruar), të gjithë pagesën e kështit të dytë të apartamentit, të paguar në vitin 2009 së bashku me shpenzimet e kryera për vitin 2009, pasi rezulton një mungesë financiare në vlerën 1.253.738 lekë.

1.18 Njëkohësisht, duket se subjekti nuk kishte mundësi që në vitin 2010⁶ të depozitonte *cash* shumën prej 2.000.000 lekësh, për pagesën e pjesësme (para afatit) të prin cipalit të kredisë, pasi është konstatuar se në deklarin e pasurisë për vitin 2009 subjekti ka deklaruar shtesë të kursimeve *cash* në banesë shumën prej 200.000 lekësh. Të përlllogaritura në mënyrë përmbledhëse nga viti 2003 e në vijim, në fund të vitit 2009 subjekti mund të kishte shumën totale prej 1.400.000 lekësh, si gjendje *cash* në banesë.

1.19 Gjithashtu, nga dokumentacioni bankar ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja, deri në datën 31.3.2010, kanë tërhequr prej bankave shumën 568.000 lekë dhe kanë depozituar shumën prej 109.000 lekësh. Këto veprime bankare i kanë mundësuar subjektit që të dispononte *cash* në këtë periudhë edhe shumën prej 459.000 lekësh (568.000 - 109.000). Ndërkohë që shpenzimet jetike nga data 1.1.2010 deri më 31.3.2010, të përlllogaritura në mënyrë proporcionale, sipas metodologjisë standard, kanë rezultuar në vlerën 153.697 lekë.

1.20 Nga sa më sipër, duke marrë në konsideratë vetëm burimet e lart përmendura, konstatohet se subjekti ka patur mundësi që të dispononte/depozitonte, për shlyerjen e kredisë në fjalë, vetëm shumën prej 1.705.303 lekësh (1.400.000+568.000-109.000-153.697 = 1.705.303 lekë), dhe jo

⁶ Depozituar *cash* në shumën 2.000.000 lekë, datë 26.3.2010, në BKT.

2.000.000 lekë që ka depozituar. Për rrjedhojë, lidhur me këtë veprim financiar, ka rezultuar një mungesë e burimeve financiare në shumën prej 294.697 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me sa më lart

1.21 Në mënyrë të përmbledhur, duke iu referuar përgjigjeve të subjektit të dhëna për pyetësonin nr. 2 - të cilat pjesërisht janë përshkruar edhe më lart - prapësimeve të përcjella me shkrim, si dhe shpjegimeve të dhëna përgjatë seancës dëgjimore, mbi gjetjet e Komisionit lidhur me këtë pasuri, subjekti është shprehur, si më poshtë vijon.

1.22 Lidhur me mosdeklarimin e shumës së marrë nga z. Rr. P. dhe të detyrimit relativ, subjekti dhe përfaqësuesi i tij kanë argumentuar se shuma prej 3.300.000 lekësh nuk mund të konsiderohej një hua, pasi nuk kishte hyrë asnjëherë në gjendjen financiare të subjektit, për sa kohë ishte depozituar nga z. Rr. P. në një llogari bankare të kredisë, ku kishte mbetur e ngrirë, me funksionin e garancisë hipotekore financiare, dhe nuk mund të tërhiqej apo të përdorej/diponohej nga z. Astrit Kalaja. Siç rezulton edhe nga dokumentet e paraqitura në Komision tërheqja e shumave në fjalë është kryer nëpërmjet nënshkrimit të njëkohshëm dhe të ndërsjellë (z. Astrit Kalaja dhe z. Rr. P.), pasi ato kanë përfunduar. Për të njëjtin shkak këto shuma nuk janë deklaruar si detyrim i mbartur, pasi ato nuk janë konsideruar ndonjëherë si detyrim, pasi ato ishin të ngrira në bankë dhe i janë rikthyer përsëri të z. Rr. P.

1.23 Lidhur me mospërputhjet mbi shumat e kthyer mbrapsht të z. Rr. P., subjekti ka deklaruar se ka gabuar në përgjigjen e pyetësonit nr. 2, duke shkëmbyer datën në të cilën ishte tërhequr shuma 2.000.000 lekë (më 8.6.2010), me datën në cilën ishte tërhequr shuma prej 1.300.000 lekë (23.02.2012), ashtu sikurse edhe për personin që i ka tërhequr, pasi në të dyja tërheqjet e kryera rezulton se janë paraqitur personalisht në bankë dhe kanë nënshkruar të dy personat (A. Kalaja dhe Rr. P.). Ky lapsus në përgjigjet e pyetësonit nuk ndryshon apo ndikon asgjë në lidhje me veprimet bankare të kryera, pasi ato janë të dokumentuara nga dokumentet përkatëse. Ndërsa mosdeklarimi i shumave të vogla të dhëna herë pas herë nga Rr. Z. P., përgjatë 5 vjetësh, për një total prej 1.300.000 lekësh, shpjegohet me faktin se asnjëra nga shumat e paguara në favor të z. Rr. P. në ato vite nuk e ka kapërcyer pragun ligjor të parashikuar për lindjen e detyrimit të deklarimit si shpenzim, duke i konsideruar ato si shpenzime të zakonshme jetese.

1.24 Lidhur me rezultatet negative të analizës financiare të Komisionit, për këtë pasuri, përkatësisht në vitin 2009, për shumën 1.253.738 lekë dhe në vitin 2010, për shumën 294.697 lekë, subjekti ka shpjeguar se ato kanë rezultuar gabimisht, për shkak të një konkluzioni të arritur mbi një përlllogaritje jo të plotë të të gjitha gjendjeve financiare të ligjshme që subjekti realisht ka pasur, pasi aty nuk janë përfshirë shumat 2.000.000 dhe 1.500.000 lekë, të tërhequra nga banka në vitin 2008, të cilat buronin nga shitja e apartamentit në vitin 2007.

1.25 Sipas subjektit, kjo ka ndodhur për shkak se në rubrikën për gjendjen *cash* në deklaratat vjetore të pasurisë, ka deklaruar vetëm shtesat e kursimeve nga pagat e veta dhe të bashkëshortes të realizuara brenda vitit përkatës apo pakësimet relative të kryera nga shpenzimi i gjendjes *cash* të mbartur nga vitet e mëparshme. Rrjedhimisht, shumat që rridhnin nga shitja e apartamentit ishin deklaruar si të ardhura në vitin 2007 dhe të depozituara në bankë, dhe tërheqja e tyre nuk ishte një

shtesë e kursimeve të gjendjes *cash*, por kalimi i tyre nga banka në banesë (mënyra e ruajtjes së të gjendjes *cash*), në pritje të kryerjes së pagesave. Ndonëse shkaku i mosdeklarimit ka qenë një gabim njerëzor në konceptimin dhe plotësimin e formularëve të deklarimit të pasurive, kjo nuk i bën këto shuma pa burim të ligjshëm, por ka pasur pasaktësi në deklarimet përkatëse. Pra, këto shuma janë disponuar në vijimësi dhe janë përdorur për pagesën e këstit të dytë dhe pjesërisht për uljen e *principalit* të kredisë bankare, siç është deklaruar ndër vite.

1.26 Lidhur me mospërputhjet e deklarimeve *cash* ndër vite, me sa është deklaruar në pyetësin nr. 2, subjekti ka shpjeguar se ndër vite ka deklaruar vetëm shtesat e kursimeve nga pagat e veta dhe të bashkëshortes, të realizuara brenda vitit përkatës apo pakësimet relative dhe në pyetësin nr. 2 ka përlllogaritur edhe totalin që u përkiste viteve specifike, ku mund të jetë kryer edhe ndonjë gabim njerëzor, por të gjitha të kursimet e deklaruara *cash*, si në deklaratat periodike vjetore, ashtu edhe në deklaratën “Vetting” kanë qenë shuma të kursyera nga të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes nga paga , pra, nga burime të ligjshme.

Vlerësimi i Komisionit

1.27 Komisioni konsideron të rëndësishëm trajtimin dhe argumentimin e dy aspekteve kryesore, lidhur me: (i) marrëdhënien midis subjektit dhe z. Rr. P. për sa i përket - disponibilitet financiar të këtij të fundit për të garantuar kredinë e subjektit në vlerën 3.300.000 milion lekë - profilin formal të kësaj marrëdhënie – nëse mund të konsiderohet hua – dhe rrjedhimisht, pasja ose jo e detyrimeve të subjektit për deklarimin e ekzistencës dhe të efekteve financiare të kësaj marrëdhënie; (ii) konsiderimin ose jo si të disponueshme, në momentin e përdorimit, të shumave me burime të ligjshme, të qarta, në vitin pararendës të përdorimit të tyre, por të padeklaruara si gjendje *cash* në fund të atij viti.

1.28 Lidhur me burimet financiare të shtetasit Rr. P., Komisioni i ka vlerësuar si të mjaftueshme për të justifikuar shumën prej 3.300.000 lekësh – të derdhura prej tij në bankën kredidhënëse, për garancinë financiare të kësaj të fundit - pasi pozicioni i tij financiar është provuar jo vetëm me gjendjet në llogaritë e tij bankare, por kryesisht me të ardhurat e konsiderueshme të realizuara nga shija e një prone në vitet e mëparshme, me çmim 28.500.000 lekë. Duke konsideruar faktin se z. Rr. P. nuk ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI, dhe për rrjedhojë nuk është e verifikueshme vijueshmëria e gjendjes/zotërimit (qoftë edhe të pjesshëm) dhe destinacioni përfundimtar i kësaj shume, nuk mund të përjashtohet mundësia se shuma 3.300.000 lekë (e përdorur për rastin në fjalë) të burojë pikërisht nga të ardhurat që z. Rr. P. ka përfituar nga shitja e sipërcituar (në një vlerë që kanë qenë më shumë se nëntëfishi i saj) – pasi ato mund të jenë ruajtur në kohë, në gjendje *cash* në banesë apo të jenë depozituar në llogaritë bankare në momente të ndryshme. Për sa më sipër dhe në mungesë të provës së kundërt, trupi gjykues e vlerëson të justifikuar burimin e shumës prej 3.300.000 lekë.

1.29 Për sa i përket cilësimit të marrëdhënies në shqyrtim, Komisioni konstaton se gjendemi përballë një veprimi ndërpersonal dhe juridiko-bankar të veçantë, për sa kohë nuk ekzistojnë të gjithë elementët që do ta bënin atë një huadhënie të mirëfilltë. Ndërsa nga njëra anë kemi një kontribut/pagesë të një shume të caktuar të hollash nga z. Rr. P., me të vetmin qëllim, krijimin e

një garancie financiare në favor të bankës kredidhënëse – për të mundësuar heqjen e hipotekës të vendosur më herët, mbi një pasuri të paluajtshme të subjektit (pikërisht si garanci për kredinë prej 3.000.000 lekësh, të përfituar prej tij) – të cilën, pas lirit nga hipoteka, subjekti e ka shitur. Kjo rrethanë sigurisht evidenton një përfitim indirekt që subjekti ka gëzuar pikërisht si rezultat i garancisë financiare të ofruar nga z. Rr. P. Për pasojë ka ekzistuar edhe një detyrim i subjektit për t'i kthyer shumën prej 3.300.000 lekësh.

1.30 Por, nga ana tjetër ndodhemi përballë një veprimi financiaro-bankar që nga këndvështrimi formal i aspektit juridiko-civil, Komisioni ka vlerësuar se nuk i ka përmbushur të gjitha elementet e parashikuara nga dispozitat ligjore për t'u cilësuar si një marrëdhënie e mirëfilltë huaje, për sa kohë neni 1050 i Kodit Civil, përcakton në mënyrë të qartë: “[...] dhënien në pronësi të palës tjetër një shumë të hollash [...]”. Kjo do të thotë që huamarrësi (për t'u cilësuar si i tillë), duhet të marrë dhe të zotërojë të hollat me të gjitha të drejtat civile të një pronari – duke i përdorur në çdo lloj kohe, mënyre dhe destinacionit. Ndërkohë që, në rastin konkret, subjekti nuk i ka disponuar për asnjë moment këto të drejta (madje as fizikisht shumën në fjalë, pasi atë e ka depozituar në bankë, z. Rr. P.), për sa kohë destinacioni/funksioni i të hollave ishte garancia financiare, dhe ato nuk mund të tërhiqeshin nga llogaria bankare pa pëlqimin dhe nënshkrimin e z. Rr. P., dhe aq më pak ato nuk mund të përdoreshin nga subjekti sipas pëlqimit të tij, në autonominë që do të duhej të kishte një pronar.

1.31 Në vijim të argumentimeve të mësipërme, trupi gjykues, çmon se ndonëse rrethanat e sipërcituara çojnë në moscilësimin e marrëdhënies financiare, që është duke u analizuar si një hua, në kuptimin e nenit 1050 i Kodit Civil – fakt ky që e lehtëson disi pozitën e subjektit të rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e saj si një veprim/burim. Por nga momenti që marrëdhënia në fjalë ka sjellë përfitime/lehtësime të subjektit dhe ka gjeneruar, gjithsesi, një detyrim të subjektit ndaj z. Rr. P. për të kthyer te ky i fundit shumën prej 3.300.000 lekësh, pasi të përfundonte nevoja e garancisë financiare, subjekti duhej që të kishte deklaruar ekzistencën e këtij detyrimi financiar në faqet 5 dhe 6 të deklaratës periodike vjetore të vitit 2007, si dhe shuarjen e tij në periudhën përkatëse. Trupi gjykues çmon se nisur nga rrethanat specifike, nga fakti që veprimi financiar është pasqyruar qartësisht në përshkrimin e veprimit bankar, mosdeklarimi i detyrimit në fjalë, në këtë rast përbën një pasaktësi që nuk mund të çojë në aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

1.32 Lidhur me deklaratimet e subjektit për gjendjen *cash* ndër vite dhe për ndërthurjen e tyre me zotërimin ose jo të disa shumave që subjekti i rivlerësimit i kishte përfituar nga shitja e pasurisë, i kishte depozituar në llogari bankare dhe më pas i kishte tërhequr, Komisioni evidenton faktin se në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor janë përlllogaritur vetëm shumat e deklaruara nga subjekti si *cash* në banesë, të cilat kanë rezultuar të mbuluara nga burime financiare të ligjshme – vetëm nga puna e subjektit dhe bashkëshortes – të verifikuara përgjatë viteve përkatëse.

1.33 Mospërputhjet midis deklaratimeve për gjendjen *cash* me përgjigjet e dhëna nga subjekti në pyetësonin e dytë, ndonëse rrjedhin nga një pasaktësi përlllogaritjesh dhe deklarimesh, apo

përgjigjesh të kryera nga subjekti i rivlerësimit, nuk mund të përbëjnë në vetvete shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë: (i) nëpërmjet tyre nuk ka rezultuar të jetë tentuar apo të jetë arritur që të mbuloheshin në mënyrë fiktive shpenzime, të cilat më pas, nga analiza financiare do të rezultonin me mungesë të burimeve të ligjshme; dhe (ii) as kanë rezultuar diferenca të pashpjegueshme midis gjendjes *cash* të përshkruar në deklaratën “Vetting” dhe rrjedhshmërisë logjiko-matematikore të deklarimeve të gjendjes *cash* ndër vite; por (iii) është konstatuar se deklaratimet vjetore *cash* janë përshkruar saktësisht, sipas parashikimeve përkatëse, shtesat e kursimeve vjetore (vetëm nga puna) apo pakësimet relative, ndonëse pa përfshirë disponibilitetet financiare me burime të ligjshme alternative (si në vijim).

1.34 Për sa u përket shumave prej 2.000.000 dhe 1.500.000 lekësh, të tërhequra nga subjekti prej llogarisë bankare në vitin 2008, të cilat ishin depozituar pas shitjes së një apartamenti në vlerën 3.500.000 lekë, në vitin 2007 – nga ku buronin – lidhur me pretendimin e subjektit se ato kanë qenë në disponibilitetin e tij në gjendjen *cash* në fund të vitit 2008 dhe në vitin 2009, deri në momentin e përdorimit të tyre – por subjekti nuk i ka deklaruar si *cash*, pasi ishin rregullisht të deklaruara si të ardhura vjetore (nga shitja e apartamentit) në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 dhe të dokumentuara nga dokumentet bankare si tërheqje, trupi gjykues – për shkaqet e mëposhtme – i gjen bindëse shpjegimet e subjektit, por njëkohësisht e konsideron si të pasaktë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, në pjesën e deklaratimit *cash*, për mospërfshirjen e shumës në fjalë (si gjendje *cash* në dispozicion më 31.12.2008).

1.35 Trupi gjykues arsyeton se në rastin konkret, nisur nga fakti që burimi i ligjshëm i shumës në fjalë, si dhe depozitimi dhe tërheqja nga llogaria bankare e subjektit, kanë rezultuar të provuara dhe duke pasur parasysh edhe vlerën e tyre të konsiderueshme, moskonsiderimi i tyre nga Komisioni, si të disponueshme në analizën financiare, vetëm për faktin se subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore, si gjendje *cash* në fund të vitit (për shkak të një konceptimi të gabuar të detyrimit për deklarim) – por i ka deklaruar me saktësi si të ardhura nga shitja e pasurisë – do të përbënte një penalizim jo në proporcion me gabimin/mospërbushjen e detyrimit formal nga subjekti, duke tejkalluar frymën e ligjit nr. 84/2016, që synon ndëshkimin e mungesës së burimeve të ligjshme dhe të pamjaftueshmërisë thelbësore të deklarimeve – me anë të të cilave mund të jetë tentuar, apo realizuar pasqyrimi i një gjendje pasurore të deklaruesve të ndryshme nga realiteti. Në këtë rast subjekti nuk ka deklaruar gjendjen *cash* të një shume të provuar më herët, si për burimin e ligjshëm, ashtu edhe mbi zotërimin fizik të saj.

1.36 Gjithashtu, Komisioni vlerëson se fakti që nuk jemi përballë ndonjë shume të vogël, për të cilën disponibiliteti real nga subjekti në fund të vitit, në gjendje *cash* (në mungesë të provave alternative), mund të jetë jo i besueshëm (siç ka ndodhur në një tjetër rrethanë për një shumë prej 2.000 euro), që mund të përzihet lehtësisht mes shpenzimeve jetike vjetore dhe për këtë shkak, nëpërmjet një analize logjike të arsyeshme, mund të prezumohet dhe konsiderohet si e shpenzuar përpara fundvitit, por që shuma prej 3.500.00 lekësh të jetë konsumuar tërësisht për shpenzime jetike, në një periudhë disa mujore, është më pak e besueshme dhe për rrjedhojë bën më bindës shpjegimin e subjektit se në fund të 2008 dispononte të hollat në fjalë por, për gabimin e tij nuk i ka deklaruar në gjendje *cash*. Për rrjedhojë, trupi gjykues, çmon se duhet të konsiderohet me burim

financiar të ligjshëm e gjithë pagesa e këstit të dytë për blerjen e apartamentit në vitin 2009 – dhe për pasojë të gjitha shumat e paguara nga subjekti për këtë pasuri (nr. 1) rezultojnë të mbuluara me burime financiare të ligjshme – për faktin se disponibiliteti i shumave të arsyetuara në pikat e mësipërme i mbulon mangësitë e konstatuara në analizën financiare paraprake. Lidhur me peshën dhe pasojën e mundshme të pasaktësisë së deklaramit të gjendjes *cash* i referohemi arsyetimit relativ/analog, në pikën 1.34, të sipërtrajtuar.

2) Tokë arë me sip. 379 m², mbi të cilën ka një sipërfaqe ndërtimi 60 m², me vlerë 1.800.000 lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, në fshatin *, Velipojë.**

2.1 Subjekti ka fituar titullin e pronësisë mbi këtë truall në bazë të kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 2.7.2013, me vlerë 1.800.000 lekë, dhe pagesa është kryer jashtë zyrës noteriale. Burimi i krijimit:⁷ kredi bankare, në vlerën 2.000.000 lekë, marrë në vitin 2011, në “Raiffeisen Bank”.

2.2 Përgjatë hetimit administrativ, Drejtoria Rajonale Shkodër e ALUIZNI-t me shkresën nr. *** prot., datë 18.1.2017, ka vërtetuar se shtetasi Rr. Rr. ka dorëzuar vetëdeklarimin me nr. *** prot., datë 30.12.2014, për legalizimin e një ndërtimi pa leje, në fshatin ***, Velipojë – të ndërtuar në vitin 2000.

2.3 Në bazë të kontratës me nr. ***, datë 5.5.2011, subjekti është financuar me kredi hipotekore në vlerën 2.200.000 lekë, nga “Raiffeisen Bank”. Qëllimi i përdorimit të kredisë është “konsumatore me hipotekë”. Pas disbursimit të kredisë në datën 10.5.2011, gjendja në llogarinë bankare të subjektit ka arritur në vlerën 3.323.908 lekë, në “Raiffeisen Bank”. Në këtë llogari, ndër të tjera, evidentohen dy tërheqje: njëra në datën 22.6.2011, në vlerën 900.000 lekë dhe tjetra në datën 16.2.2012, në vlerën 2.000.000 lekë, të cilat, sipas deklaratave periodike vjetore nuk rezultojnë të kenë shkuar për rritje të gjendjes *cash* (kursime)⁸.

2.4 Për sa më sipër, janë konstatuar mospërputhje midis deklarimeve të subjektit, në deklaratën periodike vjetore për vitet 2011 dhe 2012 – të cilat ndikojnë edhe në përllogaritjen e mundësisë financiare të subjektit për të përballuar blerjen e kësaj pasurie me burime të ligjshme – dhe përgjigjeve të tij në pyetësorin nr. 2, ku subjekti ka shpjeguar se këto shuma i ka pasur në zotërim në gjendje *cash*, nga kursimet e viteve të mëparshme.

2.5 Gjithashtu, sipas *statmenteve* bankare ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja, përgjatë periudhës 1.1.2013 – 2.7.2013, kanë tërhequr nga llogaritë e tyre bankare vlerën prej 516.000 lekësh (150.000+366.000). Shpenzimet (jetese dhe udhëtimi) për këtë periudhë, të përllogaritura në mënyrë proporcionale, kanë rezultuar në shumën 364.477 lekë. Nga ky vlerësim paraprak është konstatuar se mundësia e subjektit për të paguar *cash* me të ardhurat e vitit 2013 duket se ka qenë në shumën 151.522 lekë (516.000-364.477).

2.6 Duke konsideruar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 subjekti ka deklaruar “*gjendje në cash në banesë nga kursimet e pagës sime dhe të bashkëshortes*” në vlerën 250.000 lekë, dhe duke i përllogaritur burimet në mënyrë përmbledhëse, nga hetimet paraprake dukej se subjekti në

⁷ Deklaruar në deklaramin periodik të vitit 2013 dhe në deklaratën “Vetting”.

⁸ Referuar deklaramet në deklaratat periodike për vitet 2011 dhe 2012.

datën 31.12.2012, mund të dispononte gjendje *cash*, deri në shumën 750.000 lekë. Në këto kushte, nga rezultatet paraprake rezultoi se për pagesën e të gjithë shumës për blerjen e kësaj pasurie (nr. 2), konstatohej një mungesë e burimeve të ligjshme financiare, në shumën 898.477 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.7 Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet paraprake të Komisionit, lidhur me këtë pasuri ka shpjeguar se – siç ka ndodhur edhe për pasurinë e analizuar më sipër – në vitin 2013, ka përdorur për blerjen kësaj pasurie shumat e përfituara nga një kredi bankare, marrë më herët, në vlerën 2.000.000 lekë dhe më pas të tërhequra nga llogaria bankare përkatëse. Në vitet në fjalë, 2011 dhe 2012, subjekti ka deklaruar si gjendje *cash* në banesë, në deklaratat periodike vjetore respektive, vetëm shumat e kursyera (*cash*) nga të ardhurat familjare nga puna, duke mos e konceptuar të nevojshëm deklarimin e shumave të tërhequra nga banka, pasi ato, jo vetëm që ishin por edhe janë të provuara si të holla të disponuara nëpërmjet veprimeve bankare në fjalë, por kryesisht, përfitimi dhe burimi i tyre si të ardhura ishin deklaruar rregullisht në momentin (vitin) e disbursimit të kredisë, dhe për rrjedhojë do të rezultonte si një deklarim i dyfishtë i të njëjtave të holla me të njëjtin burim financiar.

2.8 Për këtë shkak, subjekti pretendoi se duke qenë e deklaruar si e ardhur dhe e provuar si burim i kredisë prej 2.000.000 lekësh, nuk mund të konkludohet për mungesë të burimeve financiare nga subjekti për blerjen e kësaj pasurie, por vetëm për një pasaktësi në deklarimin të gjendjeve *cash* (për mosdeklarimin *cash* të shumës prej 2.000.000 lekësh të tërhequr nga llogaria bankare në datë 16.2.2012) dhe që për këtë shkak subjekti nuk mund të penalizohej (njëlloj sikur të mos kishte pasur burim të ligjshëm të ardhurash). Në datën 31.12.2012 subjekti ka disponuar në gjendje *cash* shumën prej 2.750.000 lekësh. Subjekti konkludon se nëse do të konsideroheshin në analizën financiare shumat e tërhequra nga banka (me burim të ligjshëm), ose edhe vetëm shuma e tërhequr në vitin 2012 prej 2.000.000 lekësh, nuk do të rezultonte më mungesa financiare e shumës prej 898.477 lekësh, siç është konstatuar nga Komisioni, në analizën financiare paraprake.

Vlerësimi i Komisionit

2.9 Nisur nga situata faktike e përshkruar më sipër dhe duke e analizuar atë me të njëjtin këndvështrim që ndërthur analizën e fakteve dhe rrethanave me arsyetimin logjiko-ligjor, të përdorur në rrethanat analoge që lidheshin me burimet e pasurisë nr. 1 – në paragrafët 1.33 - 1.36, të këtij vendimi – me qëllim arritjen e një vlerësimi sa më objektiv të rastit në fjalë, si dhe duke konsideruar shpjegimet e subjektit lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni i konsideron këto të fundit si të besueshme dhe bindëse, për shkaqet që vijnë.

2.10 Rezulton i provuar fakti që subjekti ka përfitur në vitin 2011 një kredi bankare prej 2.000.000 lekësh, të depozituara në llogarinë e tij bankare. Kjo e ardhur është deklaruar saktësisht në deklaratën periodike vjetore të vitit përkatës, sikurse edhe pjesa e mbetur si detyrim i mbartur ndaj bankës kredidhënëse, rezulton e deklaruar saktësisht në rubrikën përkatëse të po të njëjtës deklaratë. Për rrjedhojë, nuk ka dyshime mbi burimin e ligjshëm të kësaj shume.

2.11 Po ashtu, në deklaratat periodike vjetore të viteve 2011 dhe 2012, subjekti, ka deklaruar gjendje *cash* në banesë, përkatësisht shumat 500.000 lekë dhe 250.000 lekë – duke specifikuar burimin e tyre “nga paga ime dhe e bashkëshortes”. Këtë specifikim subjekti e ka bërë në të gjitha kursimet *cash* të deklaruara ndër vite. Ky fakt evidenton mënyrën e të konceptuarit dhe të deklaruarit të subjektit, që ndonëse i gabuar – në kuptimin e mospërputhshmërisë me parashikimet ligjore dhe nënligjore mbi tipologjinë e zërave dhe mënyrën e deklarimeve vjetore, specifikash për sa i përket shtesës së kursimeve *cash* në banesë – qartëson faktin se pavarësisht tërheqjes të përsëritur, nga llogaritë e veta bankare, të shumave të konsiderueshme, asnjëherë nuk ka deklaruar si kursim *cash* me këtë burim (qoftë edhe të ndonjë shume minimale), në vitet përkatëse (të tërheqjeve nga banka).

2.12 Nisur nga situata faktike e sipërpërshkruar, mosdeklarimi si gjendje *cash* në banesë, në fund të vitit 2012, i shumës prej 2.000.000 lekësh, tërhequr nga banka, po në vitin 2012, mund të shpjegohet në dy mënyra: (i) ose subjekti i rivlerësimit e ka shpenzuar të gjithë këtë shumë përpara datës 31.12.2012; (ii) ose sipas interpretimit të vet, nuk e ka konsideruar të nevojshmen/detyrueshëm deklarimin e kësaj shume (ose pjesës së saj) të disponuar *de facto* si *cash* në atë datë.

2.13 Nga një analizë logjike dhe vlerësim i përbashkët i rrethanave që lidhen me këtë fakt dhe i shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se ndonëse teorikisht është i mundshëm, varianti i parë – i shpenzimit të të gjithë shumës prej 2.000.000 lekësh përpara datës 31.12.2012 – rezulton më pak bindës se i dyti. Kjo për dy fakte të provuara: nga njëra anë subjekti nuk ka paraqitur një stil jetese në nivel kaq të lartë të shpenzimeve jetike vjetore, për të justifikuar këtë shpenzim vetëm brenda disa muajve (të vitit 2012) dhe nuk ka asnjë të dhënë që të çojë në hipotizimin e shpenzimit të kësaj shume për ndonjë tjetër arsye (blerje/investim/udhëtim/kurim).

2.14 Nga ana tjetër, do të ishte kontradiktore dhe jo arsyetim logjik, që subjekti i rivlerësimit të kursente nga pagat shumën 250.000 lekë përgjatë vitit 2012 (siç është deklaruar prej tij dhe konfirmuar nga analiza financiare e Komisioni, lidhur me mundësinë e realizimit të këtij kursimi), dhe ndërkohë përgjatë një segmenti kohor edhe më të shkurtër (në më pak se një vit), brenda vitit 2012 të mund të shpenzonte shumën prej 2.000.000 lekësh. Do të ishte më normale dhe logjike që – (në mungesë të konstatimit të ndonjë shpenzimi të konsiderueshëm në një moment të caktuar) – subjekti i rivlerësimit, përgjatë vitit 2012, fillimisht të shpenzonte të gjitha të ardhurat mujore, dhe në pamjaftueshmërinë e tyre të prekte kursimet e realizuara më herët, dhe jo të konsumonte të gjitha kursimet e mbartura, dhe ndërkohë të kursente nga pagat mujore.

2.15 Gjithashtu, nëse tendenca e subjektit do të ishte shtimi fiktiv i gjendjes *cash* (pa i disponuar realisht), do të ishte mjaftuar me deklarimin e shumës prej 2.000.000 lekë (ose të një pjese të saj), si gjendje *cash* më 31.12.2012 (për sa kohë kishte burimi financiar të deklaruar më herët dhe tërheqje të dokumentuara), e cila do t’i shërbente më mirë këtij qëllimi, pa qenë nevoja që të deklaronte shumën 250.000 lekë dhe të anashkalonte shumën prej 2.000.000 lekësh.

2.16 Së fundmi, Komisioni vlerëson se një tjetër shkak, që e bën më bindës shpjegimin se subjekti e dispononte shumën prej 2.000.000 lekësh, por ka munguar në deklarimin si gjendje *cash* në fund

të vitit 2012, dhe e bën më të aplikueshëm konsiderimin e pasaktësisë në deklarim sesa mungesën e burimit financiar, është deduktimi i analizës logjike, sipas të cilës – në rastin konkret – do të gjendeshim përballë një paradoksi: nga njëra anë do të konsideronim jo të disponueshme një shumë prej 2.000.000 lekësh të provuar dhe të dokumentuar lidhur me burimin e saj të ligjshëm dhe me ekzistencën konkrete (në llogarinë bankare të subjektit), por nga ana tjetër për të njëjtin vit 2012, do të konsideronim të disponueshme shumën prej 250.000 lekësh (të deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2012), vetëm për faktin e deklarimit dhe të mundësisë financiare (hipotetike) të rezultuar nga analiza financiare. Kjo nuk do të thotë që të vihet në dyshim ligjshmëria e shumës prej 250.000 lekësh, por duke aplikuar një arsyetim logjik, konsideromi si të disponueshme edhe të shumës prej 2.000.000 lekësh, sipas Komisionit, do të përmbushte dhe do të kënaqte harmonizimin e frymës dhe të përmbajtjes së dispozitave ligjore me interpretimin dhe cilësimin e fakteve në mënyrën më korrekte dhe më objektive të mundshme, në rastin konkret.

2.17 Lidhur me peshën specifike dhe pasojat e mundshme të pasaktësisë së deklarimit të gjendjes *cash* në fund të vitit 2012 – për sa kohë është bërë për një shumë më të vogël nga sa mendohet se subjekti ka disponuar – Komisioni e çmon si të pamjaftueshme për të aplikuar masën e parashikuar nga pika 3, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016.

3) Automjet tip “Mercedes Benz”, model *, me targa ***, në vlerën 250.000 lekë, në pronësi të subjektit.**

3.1 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se pronësia mbi këtë automjet është fituar në bazë të deklaratës zëvendësuese të aktit noterial të datës 10.6.2014, me palë shitëse z. N. S. Në bazë të aktit të mësipërm çmim i shitjes është vendosur 500 euro dhe nga subjekti në cilësinë e blerësit janë shlyer detyrimet doganore, për transport dhe shpenzime të tjera që sipas deklarimeve të subjektit përbëjnë një vlerë prej 250.000 lekësh. Burimi i krijimit:⁹ të ardhurat nga pagat dhe nga kursimet *cash* në banesë.

3.2 Në datën 14.6.2014 janë kryer procedurat e zhdoganimit për këtë mjet dhe më tej subjekti ka paguar detyrimin doganor në vlerën 54.400 lekë.

3.3 Nga analiza financiare e kryer për vitin 2014 – duke konsideruar disponibilitetin financiar në gjendje *cash* të deklaruar nga subjekti në fund të vitit 2013 – ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për të përballuar blerjen dhe shpenzimet për këtë automjet.

3.4 Për sa më sipër Komisioni vlerëson se burimet financiare të përdorura për këtë pasuri kanë rezultuar të provuara dhe të mjaftueshme dhe deklaratimet kanë qenë të sakta nga subjekti.

4) Apartament me sip. 62 m², me vlerë tregu¹⁰ 3.500.000 lekë, në pjesë takuese 5/12 në zotërim të bashkëshortes, ndodhur në lagjen “**”, Shkodër. Kjo banesë ka ende në proces legalizimi një shtesë me sip. 10 m².**

4.1 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit e ka përfitur këtë pasuri me anë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 30.6.2016, ku është vendosur çelja e

⁹ Deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2014 dhe në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

¹⁰ Deklaruar, si vlerë në deklaratën “Vetting”, nga subjekti i rivlerësimit.

trashëgimisë ligjore për të ndjerin O. D., babai i bashkëshortes së subjektit, ku kjo e fundit është përfituese e ¼ pjesë të zotëruar nga i ndjeri, duke e çuar në 5/12 pjesë të këtij apartamenti në pronësi të znj. V. K.

4.2 Burimi i krijimit të saj rrjedh nga ligji për privatizimin e pronës shtetërore dhe është marrë në posedim nga paraardhësit e deklaruësës – sipas autorizimit nga Komiteti Ekzekutiv – në datën 24.5.1963.

4.3 Bashkëshortja e subjektit e ka deklaruar këtë pasuri sipas vlerës së tregut në shumën 3.500.000 lekë. Por nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni është konstatuar se në bazë të formularit nr. 2 (të përgatitur nga grupi i punës i sektorit të privatizimit në datën 15.07.1993), vlera për t'u paguar për blerjen e saj ka qenë 16.000 lekë e cila konsiderohet si një pasaktësi pa pasoja, për sa kohë pjesa takuese e pronës është e trashëguar.

4.4 Bashkëshortja e subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 ka deklaruar zotërimin e 33% të një apartamenti ndodhur në lagjen “****” të përfituar nga ligji për privatizimin, trashëgimia ligjore dhe heqja dorë nga bashkëpronësia e njërit nga trashëgimtarët. Gjithashtu, për këtë pasuri me lejen e legalizimit nr. ****, datë 20.2.2017, është legalizuar një shtesë anësore me sip. 9.9 m² të këtij apartamenti.

4.5 Në dokumentacionin e administruar nga Komisioni ndodhet: kontrata e shitblerjes¹¹ së apartamentit të banimit me nr. ****, datë 19.8.1993, me çmim blerje 1.280 lekë; formulari nr. 2, datë 15.7.1993, me treguesit kryesorë për apartamentin; certifikata familjare; akt heqje dorë me nr. ****, lëshuar në datën 21.2.2000 nga pasuria e paluajtshme për një pjesë apartament, ku z. G. D. (vëllai i bashkëshortes), heq dorë nga pjesa takuese ¼ e këtij apartamenti, duke ua kaluar në mënyrë të barabartë tre bashkëpronarëve të tjerë (përfshirë edhe znj. V. K.).

4.6 Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se duke konsideruar kohën, pjesën dhe mënyrën e përfitimit, lidhur me burimet financiare të përdorura për këtë pasuri, nuk kanë rezultuar papajtueshmëri dhe se deklaratimet e bashkëshortes së subjektit kanë qenë të sakta.

5) Lidhur me deklaratimet e gjendjes *cash* ndër vite dhe në deklaratën “Vetting”

5.1 Subjekti i rivlerësimit duke filluar nga viti 2004 ka deklaruar kursime në gjendje *cash*, nga analizimi i të cilave janë konstatuar disa paqartësi dhe për këtë shkak është ftuar subjekti, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, datë 18.4.2019, që të japë shpjegime dhe të bënte specifikimet e rastit. Nga rianalizimi i të dhënave – përfshirë edhe përgjigjet e subjektit në pyetësorin nr. 2 – mbi deklaratimet e gjendjes *cash*, ka rezultuar si më poshtë.

5.2 Subjekti – pasi kishte deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë; në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 gjendje *cash* në shumën 100.000 lekë dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006 gjendje *cash* në shumën 100.000 lekë – në shpjegimet e dhëna në pyetësorin nr. 2, ka deklaruar se gjendja e kursimeve në *cash* në vitin 2006 ka qenë në shumën 1.000.000 lekë. Kjo shumë nuk përputhet me përmbajtjen e

¹¹ Kontrata e shitblerjes me nr. ****, datë 19.8.1993, me çmim blerje 1.280 lekë me Ndërmarrjen e Banësve Shkodër.

deklaratave vjetore si më lart, pasi duke konsideruar kërkesat e formularit të deklarimit dhe duke përlllogaritur shtesat në mënyrë të përmbledhur nga viti 2004, duket se subjekti mund të kishte gjendje *cash* vetëm shumën prej 600.000 lekësh dhe jo 1.000.000 lekë, siç dhe deklaroi në këtë pyetësor.

5.3 Subjekti – në deklarimin e pasurisë për vitin 2008, ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë. Në shpjegimet e dhëna në pyetësorin nr. 2, deklaroi se gjendja e kursimeve në *cash* në vitin 2008 ka qenë në shumën 4.291.703 lekë. Duke konsideruar përshkrimet dhe kërkesat e formularit të deklaratave periodike vjetore, mbi mënyrën e deklarimit, të deklarimit dhe duke përlllogaritur shtesat në mënyrë përmbledhëse nga viti 2004 deri në vitin 2008, duket se subjekti në vitin 2008 – mund të kishte gjendje *cash* vetëm shumën prej 1.200.000 lekësh dhe jo 4.291.703 lekë, siç dhe deklaroi në pyetësorin nr. 2.

5.4 Subjekti – në deklaratën “Vetting” deklaroi gjendje *cash* në shumën 350.000 lekë, ndërsa - duke marrë në konsideratë deklaratat periodike dhe pasi janë kryer përlllogaritjet në mënyrë përmbledhëse vit pas viti – gjendja *cash* më 31.12.2016, do të rezultonte shumën 120.000 lekë, me një shtesë prej 230.000 lekësh (në periudhën 1 - 27 janar 2017). Nga analizimi i lëvizjeve të kryera në llogaritë bankare të të dy bashkëshortëve Kalaja ka rezultuar se në këtë shtrirje kohore (1 - 27 janar 2017), kanë tërhequr nga llogaritë bankare në total shumën prej 108.000 lekësh. Për rrjedhojë, edhe nëse këtë shumë do ta konsiderojmë totalisht të disponueshme *cash* në datën 27.1.2017, rezulton një mungesë burimesh për të justifikuar (të gjithë) shumën e deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën “Vetting”. Për pasojë, mbetet një shumë prej 122.000 lekësh (230.000 – 108.000), e pambuluar nga burime të ligjshme financiare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

5.5 Subjekti – lidhur me deklaratat *cash* ka pohuar se ka deklaruar për çdo vit shumën e shtuara *cash* në banesë, më datë 31 dhjetor të vitit përkatës, duke iu referuar vetëm kursimeve të realizuara nga pagat e veta dhe të bashkëshortes, apo pasimeve përgjatë vitit për të cilin kryej deklaratën, dhe jo në mënyrë të përmbledhur. Gjithashtu, në seancën dëgjimore, lidhur me mospërputhjet midis deklaratave dhe përgjigjeve të dhëna në pyetësor është shprehur se ka patur disa lapsuse apo gabime njerëzore në përlllogaritje, në përgjigje të pyetësorit apo në deklarime, të cilat përbëjnë pasaktësi pa pasojë, pasi nuk kanë ndikuar në ligjshmërinë e burimeve, për sa kohë çdo kursim *cash* i deklaruar ndër vite ka rezultuar i mbuluar nga burime financiare të ligjshme. Sipas subjektit edhe mospërputhja e përlllogaritjes së vijimësisë së gjendjes *cash*, me shumën e deklaruar si *cash* në deklaratën “Vetting”, shpjegohet pikërisht nga gabimet njerëzore, por burimet e ligjshme për krijimin e tyre kanë ekzistuar.

Vlerësimi i Komisionit

5.6 Trupi gjykues konsideron të nevojshme kryerjen e një analize logjiko-ligjore të panoramës që paraqesin deklaratat e kryera nga subjekti mbi gjendjen *cash*, për të qartësuar dinamikën, ekzistencën dhe ndërthurjen e mundshme midis tri faktorëve përcaktues: qëllim – shkak – pasojë.

5.7 Verifikimi krahasues, për sa më lart, është kryer duke mbajtur parasysh edhe shpjegimet e subjektit me qëllim vlerësimin e nivelit të besueshmërisë dhe bindshmërisë që mbartin apo transmetojnë, dhe duke u përqendruar te mospërputhja e përgjigjeve të dhëna nga subjekti në pyetësit nr. 2, me deklaratimet *cash* ndër vite, si dhe te burimet e ligjshme financiare për krijimin e shumave në fjalë.

5.8 Për sa i përket mospërputhjeve të përshkruara në këtë pikë, Komisioni – siç e ka trajtuar edhe në argumentimet e mësipërme – i konsideron ato si pasaktësi formale (në deklaram) pa pasoja thelbësore, për sa kohë (pasaktësitë) nuk janë përdorur për paraqitjen e një situatë financiare të ndryshme nga realiteti, me qëllim rritjen fiktive të të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve të kryera dhe (ndoshta) të pa justifikuar.

5.9 Në konkluzion, lidhur me diferencën e gjendjes *cash*, midis deklaratimeve vjetore dhe deklaratës “Vetting”, në shumën prej 122.000 lekësh (qoftë në rastin se kjo do të trajtohet si një pasaktësi në deklaramin *cash*, por edhe në rast se do të konsiderohej si një mangësi financiare, për krijimin e kursimit *cash* të deklaruar) – së bashku me pasaktësitë e trajtuara më sipër, për peshën minimale që ato mbartin në raport me tërësinë e procesit të rivlerësimit të subjektit, dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit, trupi gjykues i çmon si fakt/rrethanë të pamjaftueshme për të passjellë, në rastin konkret, aplikimin pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, me pasojat e parashikuara prej tij.

6) Analiza financiare

6.1 Në mënyrë të detajuar sipas viteve janë konsideruar dhe përlogaritur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet në bazë të tyre është vlerësuar mjaftueshmëria e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara nga komisioni, me të ardhura nga burime të ligjshme, sipas nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës.

6.2 Në këtë analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, deri në deklaratën “Vetting”, nga ku, pasi janë konsideruar si të disponueshme shumat e përdorura për blerjen e pasurive nr. 1 dhe 2 – siç është arsyetuar në paragrafët përkatës – ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mangësi financiare të papërfillshëm, dhe për rrjedhojë analiza financiare përfundimtare (e riparë pas shpjegimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit), në rastin konkret, nuk paraqet shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së parashikuar në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84.2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komisionin raportin mbi vlerësimin e subjektit të rivlerësimit – me nr. *** prot., datë 2.11.2017 – në të cilin është konkluduar për *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja*.
2. Sipas këtij raporti, rezulton se në bazë të informacioneve të përcjella nga organet ligjzbatuese, ngrihen dyshime të arsyeshme se subjekti është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht në atë të korrupsionit, për shkak të funksionit të tij, si dhe për favorizimin e personave të caktuar gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtar.
3. Përgjatë hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer nga Komisioni, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës, janë studiuar/lexuar edhe dokumentet dhe shkresat e klasifikuara, mbi të cilat është kryer vlerësimi dhe është konkluduar mbi figurën e subjektit të rivlerësimit nga organet ligjzbatuese dhe nga DSIK-ja.
4. Në vijim të sa më lart, Komisioni kërkoi informacion të detajuar pranë gjykatës dhe prokurorisë përkatëse dhe administroi dosjet gjyqësore dhe hetimore, lidhur me të cilat – sipas informacioneve të klasifikuara – subjekti i rivlerësimit, duke kryer funksionin e tij, kishte favorizuar në mënyrë të paligjshme persona të caktuar. Nga një analizë e përgjigjeve të marra nga këto institucione, si dhe nga studimi i dosjeve të administruara, Komisioni ka konstatuar se në shumë prej tyre subjekti i rivlerësimit nuk ishte përfshirë në vendimmarrje, pasi nuk kishte qenë pjesë e trupit gjykues i cili kishte shqyrtuar dosjet në fjalë, dhe nuk u gjet asnjë shkelje procedurale ose ndonjë arsytim i gabuar apo i pabazuar në fakte dhe ligj, që mund të kishte favorizuar personat e gjykuar, nga ku mund të bëhej lidhje dhe të gjenin mbështetje edhe informacionet e klasifikuara.
5. Për rrjedhojë, nga shqyrtimi dhe analizimi i këtij materiali, përtej dyshimeve që mund të lindnin mbi rrethanat të caktuara, nuk rezultuan prova apo *indicie* të bazuara në fakte apo në shkelje profesionale, të mjaftueshme për të provuar ose për të krijuar dyshime të arsyeshme se këto të fundit, ishin pasojë e një qëllimi të vetëdijshëm dhe të synuar nga subjekti, për të favorizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet ndikimit të paligjshëm, në favor të personave të tretë, kundrejt një përfitimi prej tij.
6. Komisioni, me anë të rezultateve të hetimit kryesisht, i njoftoi subjektin të rivlerësimit konstatimet dhe konkluzionet e arritura nga Grupi i Punës së DSIK-së, në lidhje me papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës. Subjekti, në prapësimet e tij, si dhe gjatë seancës dëgjimore, shpjegoi se konkluzionet e DSIK-së nuk qëndronin, pasi ai nuk ishte përfshirë ndonjëherë në veprimtari korruptive apo të kundërligjshme dhe as nuk kishte pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm, por kishte punuar gjithmonë në respektim të ligjit.
7. Për sa më sipër, Komisioni – pas hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016, dhe bazuar në provat dhe dokumentet e administruara, si dhe mbi dokumentet dhe

informacionet e klasifikuara, të verifikuara nga trupi gjykues pranë organeve ligjzbatuese – në vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se në raportin e dërguar nga DSIK-ja vlerësimi i kryer nuk përmban rrethana bindëse, të mjaftueshme për të konkluduar për ndonjë favorizim apo ndikim të paligjshëm, nëpërmjet funksionit të tij, apo për konstatimin e ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme me ndonjë person të përfshirë në krimin e organizuar. Gjithashtu, informacionet dhe dyshimet e ngritura mbi veprime korruptive (të përsëritura), nuk rezultojnë të provuara/bazuara, për të konkluduar bindshëm mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në to.

8. Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk i konsideron të mjaftueshme informacionet, *indiciet* dhe dyshimet e ngritura për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij. Për rrjedhojë, konstatimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit – sipas pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale nga KLGJ-ja

1. Sipas raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, të kryer nga Grupi i Punës, i ngritur pranë Inspektoratit të KLGJ-së, datë 19.3.2019, nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore, nuk janë konstatuar shkelje profesionale lidhur me gjykimet e kryera apo me aktet e përpiluara nga ky subjekt, janë konstatuar disa referenca ligjore të gabuara dhe mungesa në dispozitivin e disa vendimeve të përshkrimit mbi të drejtën dhe afatin e ankimit për palët, si dhe disa mosrespektime të afateve për përfundimin e shqyrtimit të çështjeve apo për depozitim dhe vendimit të arsyetuar. Përgjithësisht, vendimet përmbajnë strukturën e përcaktuar nga legjislacioni dhe janë të mirëstrukturuara, duke i ndarë: në pjesën hyrëse; pjesën përshkuese; arsyetuese; dhe në dispozitivin e gjykatës, me një arsyetim të qartë. Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, të arsyetimit ligjor dhe faktik të vendimeve gjyqësore, si dhe ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve.

2. Gjyqtarit Astrit Kalaja, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk i është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk i është dhënë asnjë masë disiplinore

Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

Lidhur me denoncimet

3. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku katërbëdhjetë denoncime, për subjektin e rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, të cilët janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të këtyre të fundit dhe të informacioneve të tjera të marra nga Komisioni edhe nëpërmjet organeve ligjzbatuese, në funksion të rivlerësimit të aspektit profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, bazuar në nenin 53, të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa dosje gjyqësore, si dhe një artikull/fakt i bërë publik nga mediat.

4. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet e paraqitura nga publiku dhe ka studiuar dosjet gjyqësore të administruara, ka konstatuar se nuk kanë rezultuar elemente konkrete që mund të vinin në pah ndonjë shkelje të rëndë procedurale, apo mungesa të theksuara në arsyetimet e vendimeve gjyqësore përkatëse nga subjektit i rivlerësimit, të cilat mund të evidentonin mangësi të rënda profesionale.

Fakt i njohur botërisht

5. Komisioni ka administruar, gjithashtu, të dhëna lidhur me disa rrethana dhe dinamika ngjarjesh të publikuara nga një program televiziv investigativ, në datën 11.9.2019, ora 20:45, me temë: “Gjyqtarët ‘dënojnë’ avokatin, Dhoma e Avokatisë: Gjyqtarët shkelën ligjin, avokatit nuk i është hequr licenca!”.

6. Subjektit të rivlerësimit, pasi është studiuar përmbajtja e shkrimit në fjalë dhe është parë materiali audioviziv, i është bërë me dije, duke e ftuar, që të jepte shpjegimet e tij.

7. Nga përmbajtja e këtij shkrimi, por edhe nga materiali i paraqitur nga subjekti, ka rezultuar se bëhet fjalë për një çështje penale ku z. Astrit Kalaja ka qenë anëtar i trupit gjykues (edhe pse jo që nga fillimi i atij procedimi penal) e cila – sipas denoncimit publik – nuk ka garantuar të drejtën e palëve/të pandehurve për t’u mbrojtur, pasi atyre nuk u është mundësuar/lejuar mbrojtja nga avokati që kishin zgjedhur (duke e përsëritur dhe konfirmuar edhe përpara trupit gjykues dëshirën dhe zgjedhjen e tyre për t’u mbrojtur nga avokati G. Y.) – i cili nuk kishte asnjë ndalesë ligjore për të ushtruar këtë profesion. Por, edhe pse avokati ishte i gatshëm të mbronte të pandehurit (P. Gj. dhe F. N.) – në çështjen përpara trupit gjykues në fjalë, jo gjithmonë i është lejuar që të ushtronte mbrojtjen e tyre, duke vendosur në mënyrë arbitrare zëvendësimin e tij me avokat të emëruar kryesisht – kundër dëshirës së të pandehurve.

8. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë fakt – përfshirë edhe regjistrimet *audio dhe video* të seancave gjyqësore përkatëse – ka rezultuar se konkretisht me vendim të ndërmjetëm¹², datë 25.6.2019, trupi gjykues i Gjykatës së Apelit Shkodër, ku anëtar ishte edhe subjekti i rivlerësimit, ka vendosur: “*heqjen e cilësisë së mbrojtësit të avokatit G. Y., ndaj të pandehurve P. Gj. dhe F. N.*”, pa cituar asnjë bazë ligjore – edhe pse këta të fundit në mënyrë të përsëritur kishin shprehur vullnetin e tyre (edhe përgjatë seancës në fjalë), për të pasur si mbrojtës të tyre pikërisht avokatin G.Y.

9. Gjithashtu, ka rezultuar se po i njëjti trup gjykues, me vendim të ndërmjetëm, datë 4.7.2019, ka vendosur dënimin e avokatit G. Y., me gjobë në vlerën 10.000 lekë, për kryerjen e veprimeve të papërshtatshme në sallën e gjyqimit dhe për prishjen e rregullit dhe solemnitetit të gjyqimit.

10. Për sa më lart, Komisioni konkludoi se në rezultatet e hetimit janë konstatuar fakte dhe rrethana që mund të kenë cenuar të drejtat e palëve për të zgjedhur avokatin mbrojtjes për sa kohë është pamundësuar ushtrimi i profesionit të avokatit – në rastin konkret të një individi që dispononte

¹² Kjo vendimmarrje është pasqyruar në procesverbalin e seancës në fjalë, por nuk rezulton të jetë hartuar një vendim i mirëfilltë, ku të jenë pasqyruar pjesët përkatëse (parashtrimet, arsyetimi dhe dispozitivi) dhe të firmosej nga anëtarët e trupit gjykues – siç ishte bërë me vendime të tjera të ndërmjetme, në të njëjtin procedim.

licencën përkatëse dhe gëzonte të drejtën dhe aftësitë intelektual-shëndetësore, për të përfaqësuar palët, për të përmbushur detyrat e avokatit, duke ushtruar këtë profesion të lirë dhe të autorizuar nga organet kompetente. Rrethana këto nga të cilat vërehet se trupi gjykues mund të ketë vepruar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, ligjore, nënligjore, procedurale dhe etike, në shkelje të të drejtave themelore të njeriut.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, në lidhje me problematikat e përshkruara më sipër, mbi kriterin e aftësive profesionale, ka paraqitur në Komision shpjegimet e tij dhe ka argumentuar, përgjatë seancës dëgjimore së bashku me përfaqësuesin e tij, se në procedimin penal në fjalë trupi gjykues kishte konstatuar një abuzim sistematik nga të pandehurit me të drejtën e tyre për të zgjedhur avokatin mbrojtës, duke revokuar, pranuar dhe rikërkuar disa avokatë. Gjithashtu – sipas subjektit të rivlerësimit – edhe vet avokati G. Y. kishte abuzuar me të drejtë/detyrën e përfaqësimit të dy të pandehurve, duke mos kryer një mbrojtje efikase dhe konkrete, por duke e shpërdoruar atë nëpërmjet paraqitjes tendencioze të dhjetëra kërkesave për përjashtimin e anëtareve apo të të gjithë trupit gjykues që po shqyrtonte çështjen në fjalë. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se avokati G. Y. kishte për qëllim vetëm zvarritjen e këtij procesi, dhe me këtë mënyrë sjelljeje, jo vetëm që nuk po kryente një mbrojtje efektive për të pandehurit, por as nuk po mundësonte zhvillimin e procesit në fjalë, me qëllimin e vetëm për ta çuar çështjen përpara të pa konkluduar deri në skadimin e afateve ligjore.

12. Në këto kushte, sipas subjektit gjykatës i është dashur të ekuilibrojë të drejtën e të pandehurve për t'u mbrojtur me interesin publik që procesi në fjalë të zhvillohej rregullisht, duke përmbushur detyrën funksionale, dhe për këtë qëllim nuk ka pranuar vijimin e përfaqësimit të të pandehurve nga avokati G.Y.

13. Së fundmi, subjekti ka theksuar faktin se të pandehurve në këtë procedim penal nuk u është cenuar e drejta e mbrojtjes, për sa kohë asnjë seancë nuk është zhvilluar pa praninë e avokatëve mbrojtës, dhe në vijimësi janë caktuar avokatë kryesisht – kur avokatët që rezultonin të emëruar kanë munguar – duke u dhënë atyre kohën e mjaftueshme për t'u njohur me dosjet sa herë kanë kërkuar. Këto rrethana kanë rezultuar të provuara edhe nga studimi i materialit të dosjes në fjalë të administruar nga Komisioni, në veçanti nga procesverbalet e seancave gjyqësore dhe nga regjistrimet *audio* të tyre.

Vlerësimi i Komisionit

14. Komisioni, lidhur me çështjen në fjalë dhe me faktet e përshkruara më sipër, ka konstatuar së paku një ndrydhje dhe deformim të së drejtës të të pandehurve për t'u mbrojtur nga avokati i zgjedhur prej tyre – që sipas vlerësimit dhe besimit të tyre mund të garantonte një mbrojtje më të mirë se zgjedhjet alternative të ofruara nga gjykata.

15. Ndonëse, nga njëra anë, qëndrimi dhe reagimi i gjykatës, deri diku, mund të jetë diktuar nga rrethanat specifike dhe shtytëse të krijuara në këtë proces – të shkaktuara nga qasja dhe nga veprimet e përsëritura dhe jo koherente e të pandehurve (lidhur me caktimin, për zgjedhjen dhe

revokimin e avokatëve të tyre) dhe kërkesat e përsëritura dhe këmbëngulëse të mbrojtësit të tyre për përjashtimin e gjyqtarëve (ndaj të cilave një magjistrat duhet të ketë aftësitë rezistuese dhe të gjej zgjidhje proporcionale, procedurale dhe ligjore). Nga ana tjetër është detyrë e gjykatës që në çfarëdo lloj situatë të përmbushë detyrat dhe funksionin në respekt të plotë të të drejtat e palëve, të harmonizuara ato edhe me dispozitat ligjore në fuqi. Por, çdo kufizim i një të drejte themelore të njeriut (që mbizotëron mbi të drejtat e tjera) – për më tepër kur bëhet nga një gjykatë – duhet të jetë i mirë arsyetuar dhe të shpjegohet dhe justifikohet me argumente të qarta juridike, lidhur me situatën ligjore dhe faktike që e imponon kufizimin në fjalë, përndryshe do të gjendeshim përballë një shkelje, apo një mosrespektimi në mënyrën e duhur të një të drejte të njeriut.

16. Në rastin konkret, në vijim të sa më lart, duhet specifikuar se Gjykata – edhe pse nuk i ka privuar të pandehurit nga prezenca e një mbrojtje teknike përgjatë seancave gjyqësore – në thelb, në disa seanca, nga njëra anë, nuk ka mundësuar që të pandehurit të mbroheshin nga avokati që dëshironin – z. G.Y., i cili gjendej prezent në sallën e gjyqit dhe që gëzonte titullin e avokatit dhe autorizimet përkatëse për të kryer atë profesion – dhe nga ana tjetër ka privuar, pikërisht, avokatin G.Y. që të ushtronte profesionin dhe të përmbushte impenjimin e tij për të kryer mbrojtjen e të pandehurve P. Gj. dhe F. N. Për më tepër, ky qëndrim ekstrem i Gjykatës së Apelit Shkodër nuk ka buruar nga një dispozitë ligjore ku vendimmarrja që po analizojmë të mund të mbështetej. Gjithashtu, gjykata në fjalë ka munguar që të hartojë një akt të mirëfilltë të firmosur nga gjyqtarët, ku të arsyetonte vendimmarrjen për përjashtimin e një avokati nga mbrojtja që i ishte besuar nga të pandehurit dhe të argumentoheshin në mënyrën dhe me peshën e hapësirën e duhur, rrethanat e rastit dhe mbi të gjitha të citohej baza ligjore e vendimit, pra, dispozita që i mundësonte trupit gjykues këtë lloj vendimmarrje. Shënimi konfuz i bërë në procesverbalin e seancës gjyqësore, lidhur me këtë vendim përjashtimi (*de facto*) pa një dispozitiv të qartë – përtej problematikës kryesore të mungesës së bazës ligjore dhe të pasojave të vendimmarrjes në raport me të drejtat e njeriut dhe me parimin e proporcionalitetit – përbën parregullsi dhe paqartësi procedurale në kufijtë e arbitraritetit.

17. Për sa më lart, duke konsideruar faktin që gjendemi përballë një rasti të izoluar me një problematike procedurale e cila nuk ka shkaktuar pasoja të pariparueshme, për sa kohë nuk është zhvilluar ende shqyrtimi i çështjes në fjalë, trupi gjykues çmon se – duke mos qenë këto rrethana në vetvete të mjaftueshme për çuar në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, si të paaftë nga ana profesionale, dhe rrjedhimisht si të papërshtatshëm për të vijuar në funksionin e tij – bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, dosja Gjykatës së Apelit Shkodër, lidhur me procedimin penal me nr. *** akti dhe nr. *** çështje, duhet të përcillet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore.

18. Ndërkohë që nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se të dhënat e nxjerra nga disa prej dosjeve të administruara nga Komisioni, si dhe konstatimet e bëra lidhur me mënyrën e të punuarit (*modus operandi*) të subjektit, problematikat që kanë rezultuar nuk mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale.

19. Në këto rrethana, trupi gjykues, çmon se përfundimet e sipërcituara nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për të konkluduar për papërshtatshmërinë profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe si rrjedhim mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, ka arritur së paku nivelin minimal kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit ligjor që e përcakton atë si prag kualifikimi.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
3. ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, rivlerësuar në funksionin e gjyqtarit, pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.
2. Transferimin e dosjes së Gjykatës së Apelit Shkodër, që i përket procedimit penal me nr. *** akti dhe nr. *** çështje, pranë organit kompetent (KLGJ) për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim, me përjashtim të pikës 2, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 20.12.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Olsi Komici
Kryesues

Lulzim Hamitaj
Relator

Brunilda Bekteshi
Anëtare në pakicë/kundër

Anisa Duka
Sekretare gjyqësore

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Brunilda Bekteshi, si anëtar i trupit gjykues, nuk pajtohem me vendimin nr. ***, datë 20.12.2019 të marrë nga shumica e trupit gjykues, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për shkak se subjekti i rivlerësimit, sipas vlerësimit dhe gjykimit tim, nuk arriti nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë.

Ndërsa, në lidhje me kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe me pikat e tjera të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, të cilat nuk do të analizohen në vijim, bashkohem me mendimin e shumicës së trupit gjykues.

Duke iu referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, duke mbajtur në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaratës “Vetting” dhe ato periodike, si dhe deklaratimet e subjektit i rivlerësimit mbi faktet e dala gjatë hetimit administrativ, ku në çdo rast subjekti duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues. Unë, si anëtar në pakicë/kundër, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk duhet të ishte konfirmuar në detyrë, duke mos arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, për sa arsyetoj në vijim.

Në lidhje me vlerësimin e pasurisë

1. Lidhur me mjaftueshmërinë e deklaratimeve dhe mungesën e burimeve të ligjshme për pasurinë e deklaruar në deklaratën “Vetting” - apartament¹³ me sip. 109.5 m², me vlerë 4.675.650¹⁴ lekë, në bashkëpronësi me bashkëshorten, i ndodhur në lagjen “**”, Rr. “****”, Shkodër, me nr. pasurie ***, z.k. ***, vol. ***, f. ****.**

1.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se për fitimin e kësaj pasurie fillimisht është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes me nr. ***, datë 28.2.2008, dhe më tej, pronësia është formalizuar përmes kontratës së shitjes me nr. ***, datë 29.7.2009, me vlerë 4.675.650 lekë. Burimi i deklaruar i krijimit të kësaj pasurie: kredi bankare dhe shitje e pasurisë.

- Në lidhje me burimin e deklaruar, kredi në vlerën 3.000.000 lekë, të financuar nga “Banka Kombëtare Tregtare”, si dhe derdhjen e shumës cash 3.300.000 lekë nga shtetasi Rr. P. në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit, me qëllim shlyerjen e kësaj kredie

1.2 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti, me kontratën e kredisë nr. ***, datë 14.2.2007, ka përfituar kredi në vlerën 3.000.000 lekë nga “Banka Kombëtare Tregtare” për blerjen e kësaj pasurie.

1.3 Nga verifikimi i lëvizjeve bankare të “Bankës Kombëtare Tregtare” ka rezultuar se në datën 20.2.2007 është disbursuar kredia në vlerën 2.970.000 lekë dhe në datën 27.2.2007 nga subjekti është tërhequr cash shuma prej 2.946.000 lekësh.

¹³ Blerë me kontratën nr. ***, datë 29.7.2009, të Dhomës së Noterisë Shkodër.

¹⁴ Vlera e deklaruar sipas kontratës me nr. ***, datë 29.7.2009, të Dhomës së Noterisë Shkodër, në DPV-në e vitit 2007 e këtij apartamenti është 38.400 euro.

1.4 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 subjekti deklaroi pagimin e shumës prej 3.000.000 lekësh, si kështu i parë¹⁵ për blerjen e një apartamenti me vlerë 38.400 euro, burimi i të cilit është deklaruar nga kredia e marrë në “Bankën Kombëtare Tregtare”.

1.5 Fillimisht, kredia është garantuar përmes kontratës së hipotekimit nr. ***, datë 14.2.2007, me objekt apartament me sip. 63 m², me nr. pasurie ***, ndodhur në z.k. ***, Shkodër.

1.6 Kjo pasuri, e lënë kolateral, është liruar nga banka me kontratën nr. ***, datë 24.12.2007, pasi subjekti ka siguruar kredinë e mësipërme me depozitë bankare në vlerën 3.300.000 lekë në “Bankën Kombëtare Tregtare”, nga shtetasi Rr. P. Kjo pasuri është shitur nga subjekti dy ditë pas lirimit nga hipoteka, konkretisht në datën 26.12.2007, në shumën 3.500.000 lekë, shumë e cila rezultoi sipas *statement*-it bankar e depozituar nga blerësi në dy derdhje bankare në mars të vitit 2008.

1.7 Nga hetimi rezultoi se në datën 24.12.2007, në llogari të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, në “Bankën Kombëtare Tregtare”, nga z. Rr. P. është derdhur shuma 3.300.000, me përshkrimin “derdhje në llogari për shlyerje kredie”.

1.8 Subjekti, pasi është pyetur lidhur me shlyerjen e kësaj shume, ka cituar shprehimisht: “*Të ardhurat e z. Rr. P. janë kthyer me mandatarkëtimin në datën 23.2.2012, në vlerën 2.000.000 lekë dhe pjesa tjetër gjatë viteve në mënyrë të herëpashershme, por nuk mund të përcaktoj kohën.*”

1.9 Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare është evidentuar se nga llogaria e garancisë bankare në emër të subjektit Astrit Kalaja, në datën **8.6.2010**, nga z. Rr. P. është tërhequr shuma **2.000.000** lekë¹⁶. Më tej, në datën **23.2.2012**, nga subjekti Astrit Kalaja, nga llogaria e garancisë është tërhequr shuma prej **1.300.000** lekësh.

1.10 Komisioni, nga analizimi i fakteve të dala nga hetimi administrativ, i kaloi subjektit barrën e provës, pasi:

- Dukej se subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar as marrjen e huas nga z. Rr. P., dhe as mbartjen e detyrimit të shumës prej 3.300.000 lekësh ndaj huadhënësit (z. Rr. P.). Po ashtu, nuk ishin deklaruar pagesat e subjektit për shlyerjet (kthimin pas) e këtyre shumave ndaj z. Rr. P., të pretenduara si të kryera në vitet 2008 – 2013.

1.11 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, si dhe në seancë dëgjimore, ka parashtruar se *shuma 3.300.000 lekë nuk është hua, por garanci e vendosur nga shtetasi Rr. P. për garantimin e kredisë. Kjo shumë nuk është përdorur nga ana ime për t’u konsideruar si hua, pasi ka qenë e ngurtësuar dhe ai s’kishte pasur mundësi ta përdorte.* Po ashtu, subjekti ka parashtruar se mes tij dhe shtetasit Rr. P nuk kishte pasur ndonjëherë kontratë huaje, sipas parashikimeve të Kodit Civil. Në lidhje me mosdeklarimin e kësaj huaje subjekti ka parashtruar se kthimi i fondeve që ishte kryer nga gjendja e ngurtësuar, nuk ishte konsideruar prej tij si kthim apo ulje detyrimi, pasi nuk ishin përdorur të ardhura familjare.

¹⁵ Në këtë periudhë mes subjektit dhe shoqërisë së ndërtimit nuk ka pasur ndonjë kontratë formale të lidhur mes tyre për porositjen/ blerjen e këtij apartamenti, pasi kjo kontratë është nënshkruar më 28.2.2008, me nr. ***.

¹⁶ Tërheqje e kryer në bazë të kërkesës për tërheqje të firmosur nga klienti z. Astrit Kalaja.

Vlerësimi i pakicës

1.12 Në vlerësim të fakteve dhe provave të disponuara gjatë hetimit, në raport me parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, në ndryshim nga shumica, ndaj mendim ndryshe, duke e kualifikuar veprimin e kryer nga shtetasi Rr. P. në favor të subjektit si një marrëdhënie “huaje” dhe jo garanci hipotekore.

1.13 Shuma 3.300.000 lekë rezulton të jetë derdhur *cash* nga shtetasi Rr. P. në datën 24.12.2007, në llogari të subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin “*derdhje në llogari për shlyerje kredie*” dhe jo të ketë qenë gjendje në llogarinë e këtij shtetasi, dhe më tej të ngurtësohej si garanci për llogari të kredidhënësit deri në shlyerjen përfundimtare të kredisë. Pra, qëllimi i derdhjes së kësaj shume, sikurse konstatohet nga veprimi bankar, është për shlyerje kredie.

1.14 Sipas kontratës së kredisë bankare (e siguruar me depozitë bankare) nr. ***, datë 27.12.2007, rezulton që zëvendësimi i kolateralit është bërë nëpërmjet garantimit nga subjekti i rivlerësimit si titullar i llogarisë së tij bankare në shumën 3.300.000 lekë (ndër parashikimet e tjera kontraktore citohet si referencë pika 8.1 e nenit 8 të kësaj kontrate).

1.15 Në përmbushje të elementeve ligjore të kontratës së sipërpërmendur, konstatohet se në asnjë dispozitë të saj nuk pasqyrohet shtetasi Rr. P me cilësinë e dorëzanit.

1.16 Gjatë hetimit ka rezultuar që shuma nuk ka mbetur e ngurtësuar, por ajo është tërhequr, thënë ndryshe, është prekur nga vetë subjekti i rivlerësimit në datën 8.6.2010, në shumën 2.000.000 lekë (referuar mandatit bankar të BKT-së, dega Shkodër), kohë në të cilën ende nuk ishte shlyer kredia bankare.

1.17 Kredia e përfituar nga subjekti, dhe e përdorur si burim krijimi për këtë pasuri, është shlyer nga subjekti i rivlerësimit në qershor të vitit 2011 (referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 18.1.2017, të BKT-së, dega Shkodër), ndërsa shuma 1.300.000 lekë, e mbetur nga shuma e derdhur nga shtetasi Rr. P., vijonte të qëndronte në llogarinë bankare të subjektit, deri në shkurt të vitit 2012, kohë kur rezulton se subjekti e ka tërhequr atë. Në vlerësimin tim, duket e pakuptimtë mbajtja e kësaj shume në këtë llogari edhe pas qershorit të vitit 2011, kur kredia ishte shlyer plotësisht, sepse qëllimi i mbajtjes së kësaj shume, sipas pretendimit të subjektit, ishte pikërisht garanci për shlyerje kredie.

1.18 Gjithashtu, në ndryshim nga pretendimi i subjektit në prapësime se *kthimi i fondeve ishte kryer nga gjendja e ngurtësuar*, shtetasi Rr. P. ka deklaruar në deklaratat noteriale të datave 23.10.2014 dhe 6.1.2017 se: “[...]...duke filluar nga shtatori i vitit 2008 e deri në kohën që ka përfunduar shlyerja e kredisë në muajin shkurt 2013, nga Astrit Kalaja kohë pas kohe kam marrë shuma parash që varionin nga 50.000 deri në 150.000 lekë të reja...”, [...] “Me mbylljen e kredisë, lekët që kishin mbetur në llogarinë e garancisë, rreth 1.300.000 lekë, ia kam kthyer z. Astrit Kalaja, meqenëse gjatë viteve që kjo shumë ka qenë e bllokuar, unë këto lekë ia kisha marrë”.

1.19 Në ndryshim nga tërheqja e shumës 2.000.000 lekë nga subjekti në datën 8.6.2010, ku, në kërkesën për tërheqje përshkruhet se do të paguhet shtetasi Rr. P., tërheqja e radhës në llogarinë bankare për shumën 1.300.000 lekë nuk pasqyron një përshkrim të tillë, fakt që bie në kundërshtim me deklarinimin e shtetasit Rr. P. në deklaratën e tij të sipërcituar se: “Me mbylljen e kredisë, lekët që kishin mbetur në llogarinë e garancisë, rreth 1.300.000 lekë, ia kam kthyer z. Astrit Kalaja,

meqenëse gjatë viteve që kjo shumë ka qenë e bllokuar, unë këto lekë ia kisha marrë". Mbi këto prova dhe konstatime vërej se subjekti i rivlerësimit jo vetëm që ka tërhequr për llogari të tij shumën 1.300.000 lekë, por as nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse destinacionin e vijueshmërisë së përdorimit të saj.

1.20 Pra, dukshëm provohet se shuma 3.300.000 lekë është shlyer me këste, në kohë dhe në shuma të ndryshme, në ndryshim nga pretendimi se ajo ishte ngurtësuar deri në shlyerjen e kredisë.

1.21 Po ashtu, pretendimi i subjektit në prapësime se kthimi i fondeve nuk ishte konsideruar prej tij si kthim apo ulje detyrimi, nuk qëndron, *pasi nuk ishin përdorur të ardhura familjare*, për sa kohë subjekti ka deklaruar se shuma 1.300.000 lekë është kthyer prej tij në këste nga viti 2008 – 2013, duke përdorur pikërisht të ardhurat nga kursimet e tij. Në ndryshim nga shumica që merr të mirëqenë dhe përllogarit në analizë financiare edhe shumën 3.500.000 lekë, të tërhequr nga subjekti në vitin 2008, duke prezumuar në këtë mënyrë faktin se për sa kohë subjekti rezulton në balanca pozitive, ai ka pasur mundësi të paguajë edhe këstet e shumës 1.300.000 lekë, ndaj mendim ndryshe dhe vlerësoj që shuma 3.500.000 lekë nuk duhet përllogarithur në analizë financiare dhe në këto kushte vetë balancat negative të konstatuara në rezultatet e hetimit, të cilave i qëndroj, bëjnë të pamundur aftësinë paguese të kësteve.

1.22 Qartazi provohet fakti se jo vetëm që shuma nuk ka qenë gjendje për qëllim të shlyerjes së kredisë deri në përfundimin e saj, por me këtë shumë subjekti i rivlerësimit, me veprimet e tij bankare, është sjellë si zotërues i saj me të drejta reale të plota, duke e ushtruar të drejtën e përdoruesit të saj në kohë të ndryshme, si përgjatë shlyerjes së kësteve të kredisë, duke tërhequr në vitin 2010 shumën 2.000.000 lekë, dhe po ashtu edhe pas shlyerjes së saj në qershor të vitit 2011, duke tërhequr shumën 1.300.000 lekë në shkurt të vitit 2012.

1.23 Për analogji, sikurse një subjekt deklaron detyrimet financiare, p.sh. kredinë e marrë, si dhe shlyerjen e kësteve të saj, edhe nëse do të merrnim të mirëqenë faktin se derdhja e shumës 3.300.000 lekë nga shtetasi Rr. P. ka qenë një detyrim financiar ndaj tij, për ta bërë të besueshëm veprimin reciprok me këtë shtetas, subjekti duhej të kishte deklaruar në kohë reale këtë detyrim financiar, si dhe shlyerjet e pretenduara, të cilat kanë qenë relativisht në vlera të konsiderueshme.

1.24 Subjekti, në asnjë prej deklarimeve të tij në deklaratat periodike vjetore nga viti 2008 deri në vitin 2013 nuk rezultoi të kishte deklaruar kryerjen e pagesave (kthimin pas) të kësaj shume z. Rr. P., por ai i deklaroi këto shlyerje, së bashku me huadhënësin, vetëm gjatë hetimit administrativ. Ky deklaram i palëve duket të jetë i sforcuar, me qëllim provueshmërinë e mandatit të tërheqjes së shumës 1.300.000 lekë në shkurt të vitit 2012, pasi në këtë mandat nuk është përshkruar se pagesa do të shkojë në favor të shtetasit Rr. P., sikurse ishte përshkruar në mandatin e tërheqjes së shumës 2.000.000 lekë. Por, nga ana tjetër, ky sforcim çon subjektin në mosdeklarimin e destinacionit të përdorimit të kësaj shume pas tërheqjes.

1.25 Një arsye tjetër që legjitimon marrëdhënien e huas është edhe fakti që shlyerja e shumës 1.300.000 lekë ndaj shtetasit Rr. P., shumë që i përkiste këtij shtetasi, megjithëse u tërhoq nga subjekti në shkurt të vitit 2012, vijoi të shlyhej ndaj shtetasit Rr. P. deri në vitin 2013.

1.26 Po ashtu shpjegimi i subjektit se ka vijuar të paguajë hera herës shtetasin Rr. P. deri në vitin 2013, nuk qëndron, për sa kohë prej qershorit të vitit 2011, kohë në të cilën ishte shlyer tërësisht kredia e marrë në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit pretendon se mbante gjendje në llogarinë e tij

shumën 1.300.000 lekë, ndërsa ai duhej që me shlyerjen e kredisë njëkohësisht të shlyente përfundimisht edhe dorëzanin Rr. P., sipas pretendimit të tij se shuma 3.300.000 ishte ngurtësuar me një qëllim të caktuar. Për pasojë, veprimet e kryera nga subjekti lidhur me shumën 1.300.000, sipas pretendimit të tij dhe shtetasit Rr. P. se kjo shumë është shlyer hera herës prej vitit 2008 deri në vitin 2013 në vlera nga 50.000 lekë deri në 150.000 lekë, janë tregues i një marrëdhënieje huaje të paformalizuar midis këtyre dy shtetasve.

1.27 Nga ana tjetër, vlerësoj që në analizë të veprimeve dhe pretendimeve të sipërcituara, edhe po të qëndroj në variantin e subjektit se shuma 1.300.000 lekë i takonte atij, pasi e kishte shlyer shtetasin Rr. P. ndër vite, atëherë, minimalisht subjekti duhet ta kishte deklaruar këtë shumë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 (kohë në të cilën e ka tërhequr me kërkesën e tij në bankë) si gjendje likuiditeti.

1.28 Të gjithë veprimet e sipërpërmendura tregojnë marrëdhënien e subjektit me këtë shumë dhe me shtetasin Rr. P., duke derivuar një marrëdhënie huaje të pranuar me veprimet e kryera, por të paformalizuar në një akt noterial. Fakti që gjendemi përpara një marrëdhënieje huaje, mbështetet plotësisht në dispozitat ligjore të Kodit Civil, konkretisht, në nenin 1050, pasi njëra palë i ka dhënë palës tjetër në llogari të saj një shumë të hollash, të cilën detyrohet ta kthejë, si dhe në nenin 1052 të po këtij Kodi, ku parashikohen rastet e palëve kur merren vesh për kthimin me këste të parave, siç edhe ka ndodhur midis huadhënësit dhe huamarrësit. Në këtë këndvështrim, të gjithë veprimet e kryera janë ndërmarrë dhe përkojnë me këto parashikime ligjore.

1.29 Nën argumentet dhe parashikimet ligjore të sipërpërmendura, konstatoj se: (i) provohet derdhja e shumës nga huadhënësi për një qëllim të caktuar (shlyerje kredie); (ii) provohet shlyerja pjesore e saj në vlerën 2.000.000 lekë, nga huamarrësi; (iii) deklarohet gjatë hetimit kthimi nga huamarrësi i vlerës së mbetur 1.300.000 lekë, në formën e kësteve; (iv) deklarohet gjatë hetimit kthimi i shumës me këste.

- ✓ Mbi këtë nivel provueshmërie subjekti duhet të kishte deklaruar marrjen e huas nga z. Rr. P., si dhe mbartjen e detyrimit të shumës prej 3.300.000 lekësh ndaj huadhënësit z. Rr. P.
- ✓ Subjekti nuk ka deklaruar shlyerjen e detyrimit 1.300.000 lekë, me këste, shtetasit Rr. P., përgjatë viteve 2008 – 2013.
- ✓ Subjekti, me tërheqjen e shumës 2.000.000 lekë në datën 8.6.2010, ka prekur llogarinë e garancisë pa shlyer kredinë bankare, duke vepruar në tejkalim të qëllimit të kësaj llogarie.

2. Lidhur me deklaratimet *cash* nga subjekti i rivlerësimit, në periudhën/vitet që janë kryer pagesat për këtë pasuri:

2.1 Siç ka rezultuar nga hetimi administrativ, në datën 26.12.2007 subjekti i rivlerësimit ka shitur në shumën 3.500.000 lekë apartamentin me nr. pasurie ***, që kishte lënë kolateral për marrjen e kredisë në vitin 2007, në shumën 3.000.000 lekë.

2.2 Sipas transaksioneve bankare rezulton se blerësi i kësaj pasurie, shtetasi A. V., ka paguar në favor të subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në datën 4.3.2008, shumat 2.700.000 lekë dhe 600.000 lekë, dhe se shuma e mbetur sipas deklaratimit të subjektit ka qenë dhënë në formë paradhënieje në *cash*.

2.3 Komisionit, nga verifikimi i deklaratës për vitin 2008, i rezultoi se subjekti kishte deklaruar të ardhurat e përfituara nga kjo pasuri, në llogarinë e pagës në “Raiffeisen Bank”.

2.4 Po ashtu, Komisionit i rezultoi se nga transaksionet bankare të kryera më pas, subjekti i rivlerësimit kishte tërhequr në datën 21.4.2008 shumën 1.000.000 lekë, si dhe në datën 6.5.2008 shumën 2.500.000 lekë (referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 23.1.2017, të “Raiffeisen Bank”).

2.5 Në shpjegimet e dhëna nga subjekti në pyetësonin nr. 2, këto shuma të tërhequra në vitin 2008 deklarohen/shprehen si burim për pagesën e këstit të dytë për blerje apartamenti në vitin 2009 (rreth 1.700.000 lekë), si dhe për shlyerjen e kredisë para kohe në vitin 2010 (2.000.000 lekë).

2.6 Nga verifikimi i deklaratës periodike për vitin 2008 subjekti ka deklaruar kursime në gjendje *cash* në shtëpi në shumën 400.000 lekë, nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

2.7 Po ashtu, në deklaratën për vitin 2009, subjekti ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes në gjendje *cash* në shtëpi, në shumën 200.000 lekë.

2.8 Po në këtë deklaratë subjekti ka deklaruar se ka pakësuar vlerën në lekë, duke shlyer diferencën e çmimit të pasurisë nr. 1 të deklaruar në deklaratën “Vetting” në shumën 13.400 euro (1.700.000 lekë), me burim nga shuma 3.500.000 lekë, e përfituar nga shitja e pasurisë në dhjetor të vitit 2007, për të cilën është qartësuar më sipër.

2.9 Subjekti është pyetur në lidhje me mospërputhjet e vërejtura midis deklarimeve të gjendjes *cash* në deklaratat periodike me të ardhurat e përdorura për këtë pasuri, si dhe pagesat e kredisë, pasi nuk deklarohet burimi i krijimit të tyre në këto deklarata.

2.10 Në përgjigje të pyetësonit subjekti ka pretenduar gjendje tjetër *cash* nga ajo e deklaruar, duke përfshirë edhe të ardhurat nga shitja e pasurisë në shumën 3.500.000 lekë, në vitin 2007.

2.11 Ndryshe nga shumica në këtë vendimmarrje, ndaj një tjetër qëndrim, tashmë të konsoliduar edhe nga vendimmarrjet¹⁷ e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

2.12 Konstatoj se subjekti ka qenë i mirënjohur me mënyrën e deklarimit të gjendjes *cash*, duke saktësuar ekzaktësisht këtë gjendje në secilin vit kalendarik dhe, po ashtu, ka deklaruar edhe burimin e krijimit të secilës gjendje *cash*. Fakti që subjekti ka deklaruar si burim krijimi të gjendjes *cash* të ardhurat nga pagat të tij dhe të bashkëshortes, paga të cilat tërhiqen nëpërmjet sistemit bankar dhe, po në këtë logjikë, edhe të ardhurat nga shitja e shtëpisë në shumën 3.500.000 lekë të tërhequra nga sistemi bankar, do të duhet të ishin deklaruar si gjendje *cash*, për t’u bërë deklarimi i saktë dhe i vërtetë dhe pranuar si i tillë.

¹⁷ Vendimi (JR) nr. 7/2019 dhe nr. 11/2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Vendimi (JR) nr. 11/2019, i cili përcakton se: [...] Referuar nenit 4, pika 1, shkronja “d” e të njëjtit ligj, në objektin e deklarimit, sipas kësaj dispozite, përfshihet në konceptin e pasurisë së deklarueshme edhe vlera e likuiditeteve në gjendje *cash*, për të cilat, si për çdo pasuri tjetër, duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor, në raport me deklarimin e mëparshëm mbi të njëjtën pasuri. [...] Gjithashtu, neni 7 i të njëjtit ligj përcakton në mënyrë të shprehur se në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë të deklaruar më parë, sipas nenit 6 të këtij ligji. Në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore, janë miratuar edhe modelet e formularëve të deklarimeve periodike, të cilat, në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave private, në shpjegimet orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklarimit, udhëzojnë: *Përshkruani hollësisht ndryshimet (shesat, pakësimet) [...] të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. [...] [...] “25 Para miratimit të përmbajtjes aktuale të këtij neni, me miratimin e ligjit nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003”, ky detyrim ligjor përcaktohet shprehimisht në të njëjtën mënyrë nga pika 7, e nenit 15, e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. [...] Faqe 19 nga 20.*

2.13 Lidhur me të ardhurat në shumën 3.500.000 lekë nga shitja e pasurisë në vitin 2007, të cilat subjekti i ka tërhequr nga banka në vitin 2008 (sikurse saktësova më sipër), nuk rezulton që ta ketë deklaruar këtë gjendje *cash*, ndërsa e përdor si burim të pagimit të këstit të dytë në vitin 2009 të pasurisë “Vetting”, si dhe për shlyerjen në vitin 2010 të kredisë së përfituar në vitin 2007.

2.14 Në parashtrimet e tij subjekti ka pretenduar se ka deklaruar shtesa, duke lënë të nënkuptohet se shumat e gjendjes *cash* të deklaruara janë mbi të ardhurat e përfituara nga shuma 3.500.000 lekë.

2.15 Nuk konstatoj që subjekti të ketë deklaruar në asnjë deklaratë periodike vjetore shumën 3.500.000 lekë, që prej fitimit të saj si gjendje *cash*, çka bën të papranueshëm pretendimin se ka deklaruar shtesë këtë shumë. Në këto kushte nuk bie dakord me shumicën për të pranuar se burimi i krijimit të shumës 1.700.000 lekë, të paguar në vitin 2009 si shlyerje e këstit të fundit të pasurisë nr. 1, deklaruar në deklaratën “Vetting”, ka qenë një pjesë e shumës 3.500.000 lekë, për sa kohë nga subjekti nuk është deklaruar kjo gjendje *cash* në deklaratën për vitin 2008 dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pranoj pretendimin e subjektit se në mënyrë hipotetike jemi më shumë përballë mosdeklarimit të gjendjes *cash* dhe jo të pamundësisë konkrete të disponimit apo burimit për këto shuma.

2.16 Në mënyrë kronologjike, nuk bie dakord me shumicën për të legjitimuar burimin e krijimit të shumës 2.000.000 lekë, me të cilën është shlyer në vitin 2010 një pjesë e kredisë e marrë në vitin 2007, si e ardhur edhe nga pjesa e mbetur e shumës 3.500.000 lekë në vitin 2009, për sa kohë kjo shumë nuk është deklaruar në gjendjen *cash* në vitin 2008, kur u përfitua për herë të parë dhe nuk është deklaruar as edhe në vitin 2009 pjesa e mbetur nga viti paraardhës.

2.17 Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve për një subjekt deklarimi matet dhe vlerësohet vetëm përmes deklarimeve të sakta dhe të plota, në të kundërt, ashtu sikurse prezumohen të pranuar nga shumica, mund të prezumohen edhe të shpenzuara. Pikërisht se ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar, u vesh detyrimin për deklarim të çdo të dhëne dhe forme, vlerësoj se ato nuk duhej dhe nuk duhet të merren në konsideratë.

2.18 Në këtë kontekst vlerësoj se është shpenzuar kjo shumë, për sa kohë janë konstatuar veprimet e mëposhtme:

- në datën 6.5.2008 subjekti ka tërhequr në “Raiffeisen Bank” shumën 2.500.000 lekë;
- nga verifikimi në sistemin *TIMS* subjekti, së bashku me bashkëshorten, rezulton të ketë udhëtuar drejt Stambollit në datën 19.6.2008;
- në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se në vitin 2008 ***kishte shpenzuar shumën 1.000.000 lekë, si shpenzime kurimi në Ankara.***

2.19 Mosdeklarimi i gjendjes *cash* në fund të vitit 2008, por edhe mosdeklarimi i shpenzimit të kryer për kurim po në këtë vit, janë tregues i shpenzimeve të kryera. Natyra e këtij shpenzimi kurimi jashtë vendit, nga njëra anë është e drejtë legjitime e subjektit, por nga ana tjetër padyshim provon shpenzimet e kryera.

2.20 Në vijim të arsyetimit ligjor mbi provueshmërinë e gjendjes *cash*, vlerësoj se detyrimi ligjor i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pasuritë ka lindur që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, përcaktimet e të cilit kanë qenë të qarta në këtë drejtim, lidhur me

deklarimin e çdo pasurie, të paluajtshme, të luajtshme, përfshirë edhe likuiditetet në gjendje *cash*, si dhe shtesat dhe ndryshimet në to. Për rrjedhojë, çmuj se marrja në konsideratë e këtij likuiditeti është në vlerësimin tim një argument që nuk mbështetet në ligjin nr. 9043/2003, ndryshuar, i cili ka parashikuar në mënyrë të qartë detyrimin e çdo subjekti rivlerësimi për të deklaruar çdo shtesë dhe pakësim të pasurisë ***në çdo formë*** që ajo ndodh përgjatë një viti periodik.

2.21 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit në prapësimet e tij lidhur me **gabime njerëzore të bëra si pasojë e kuptimit të gabuar për plotësimin e kërkesave të deklaratave periodike vjetore për çdo vit**, nuk mund të pranohej nga shumica, pasi tashmë ky vlerësim është qartësuar, hetuar dhe konsoliduar nga vendimmarrjet e Kolegjit të Apelimit ku, ndër të tjera, Komisioni orientohet se: për zgjidhjen e çështjeve¹⁸ *të ngjashme në të ardhmen ...të mos prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve cash si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklarata periodike [...].*

2.22 Nga ana tjetër, ndaj mendim ndryshe nga shumica, nisur edhe nga qëndrimi i mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, por edhe nga detyrimi ligjor i mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, për të deklaruar me vërtetësi dhe saktësi çdo pasuri, burimin e saj, si dhe gjendjen *cash* nga viti në vit dhe, po ashtu, çmuj se nuk mund të lejohet prezumimi i gjendjes *cash* të padeklaruar, si përpjekje e subjektit për të rregulluar situatën financiare.

✓ Në konkluzion të fakteve dhe arsytimeve të përmendura më sipër, vlerësoj se:

- i. Balanca negative e konstatuar në rezultatet e hetimit administrativ, në shumën 2.806.597 lekë, mbetet e pandryshuar.
- ii. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me likuiditetin “*gjendje cash ndër vite*”, të përdorur për këtë pasuri, për sa kohë saktësia¹⁹ e deklaratave të subjektit është e rëndësishme për të kuptuar saktësisht gjendjen reale financiare të tij.

3. Lidhur me blerjen e pasurisë tokë arë, me sip. 379 m², me sip. ndërtimi 60 m², në vlerën 1.800.000 lekë, datë 2.7.2013, në fshatin ***, Velipojë, ka rezultuar se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për të investuar në blerjen e saj në datën 2.7.2013, në shumën 898.477 lekë dhe në pamundësi financiare për gjithë vitin 2013, në shumën 1.552.859 lekë.

3.1 Në ndryshim nga mendimi i shumicës, e cila merr në konsideratë ekzistencën e gjendjes *cash* në vitin 2012, të padeklaruar nga subjekti, si rezultat i tërheqjes së kredisë së disbursuar në vitin

¹⁸ Vendimi (JR) nr. 7/2019 dhe nr. 11/2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Vendimi (JR) nr. 11/2019, i cili përcakton se: [...] Referuar neni 4, pika 1, shkronja “d” e të njëjtit ligj, në objektin e deklaramit, sipas kësaj dispozite, përfshihet në konceptin e pasurisë së deklarueshme edhe vlera e likuiditeteve në gjendje *cash*, për të cilat, si për çdo pasuri tjetër, duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor, në raport me deklarimin e mëparshëm mbi të njëjtën pasuri. [...] Gjithashtu, neni 7 i të njëjtit ligj përcakton në mënyrë të shprehur se në deklarimin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë të deklaruar më parë, sipas neni 6 të këtij ligji. Në përputhje me përcaktimet e mësipërme ligjore, janë miratuar edhe modelet e formularëve të deklarimeve periodike, të cilat, në rubrikën e ndryshimeve të pasurive dhe interesave private, në shpjegimet orientuese për subjektet lidhur me mënyrën e deklarimit, udhëzojnë: *Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesat, pakësimet) [...] të çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit. [...]. [...] “25 Para miratimit të përmbajtjes aktuale të këtij neni, me miratimin e ligjit nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”, ky detyrim ligjor përcaktohej shprehimisht në të njëjtën mënyrë nga neni 15, pika 7 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. [...] Faqe 19 nga 20.*

¹⁹ Referuar vendimit nr. 9/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

2011, mbaj të njëjtin qëndrim për çështjen e gjendjes *cash*, si edhe në pasurinë e parë të përmendur më sipër që, për sa kohë subjekti nuk e ka deklaruar saktësisht gjendjen *cash* në fund të vitit, nuk mund të merret në konsideratë apo të prezumohet ajo çka ka pretenduar dhe ka deklaruar përgjatë hetimit administrativ, me qëllim për të rregulluar pamundësitë e tij financiare në vitet e konstatuara nga Komisioni.

- ✓ Në konkluzion, subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm lidhur me aftësinë paguese (gjendjen *cash*), për blerjen e kësaj pasurie.

4. Pamjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit mbi likuiditetet, mospërputhjet e konstatuara edhe në prapësimet e subjektit, pasi:

- i. subjekti, në pyetësin nr. 2, ka parashtruar se gjendja në fund të vitit 2008 ka qenë 4.291.703 lekë, ndërsa në prapësime ka parashtruar se gjendja në fund të këtij viti ka qenë 3.891.703 lekë. Po kështu, edhe për vitin 2009, subjekti, në prapësimet e tij, ka parashtruar se gjendja në fund të këtij viti ka qenë 2.200.000 lekë, ndërsa në pyetësin nr. 2 ka deklaruar se kjo gjendje ka qenë 2.791.703 lekë;
 - ii. subjekti parashtron të dhëna kontradiktore edhe për vitet 2012 dhe 2013, gjithnjë mbi gjendjet në fund të vitit përkatës,
- përforcojnë të gjithë arsyetimin e bërë nga ana ime në këtë mendim pakice.

VLERËSIMI TËRËSOR

Lidhur me kontrollin e pasurisë,

Unë, si anëtar në pakicë/kundër, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk duhet të ishte konfirmuar në detyrë, duke mos arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi nga hetimi administrativ, në vlerësim të provave të administruara në raport me shpjegimet e subjektit të arsyetuara më sipër, ka rezultuar se subjekti:

Ka mospërputhje dhe pamjaftueshmëri në deklaratimet vjetore të pasurisë, si dhe në deklaratën “Vetting”, pasi nuk ka deklaruar huan e marrë në shumën 3.300.000 lekë nga z. Rr. P. dhe as mbartjen e këtij detyrimi ndaj këtij huadhënësi, si të kryera në vitet 2008 – 2013, si dhe as gjendjen e likuiditetit në shumën 1.300.000 lekë, të tërhequr nga llogaria e tij bankare në vitin 2012.

Ka pamjaftueshmëri të deklarimeve ndër vite, si dhe në deklaratën “Vetting”, mbi gjendjen *cash*, ***duke rezultuar në pamjaftueshmëri financiare në shumën 2.806.597 lekë***, për të justifikuar shpenzimet, investimet e kryera, si dhe kursimet e deklaruara në periudhën 2003 –2016.

Në vlerësimi tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit e pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave për këtë kriter, unë, si anëtar në pakicë/kundër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, nuk ka arritur nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë dhe ka bërë deklarime të pamjaftueshme në lidhje me kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues, që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, z. Astrit Kalaja, nuk është i drejtë, pasi nuk i ka përmbushur të tria

kushtet e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, por vetëm dy prej tyre (“b” dhe “c”), duke munguar, sipas pakicës, plotësimin e kushtit të parashikuar në germën “a”, të po kësaj pike.

Për arsyet e sipërcituara, sipas parashikimeve të pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në provat që disponon Komisioni dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, ky i fundit nuk arrin nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë dhe, për rrjedhojë, krijoj bindjen se shumica nuk duhet të kishte disponuar konfirmimin në detyrë të këtij subjekti, por shkarkimin e tij nga detyra.

Brunilda Bekteshi

Anëtar në pakicë/kundër